



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 700 Akti

Nr. 794 Vendimi  
Tiranë, më 4.9.2024

V E N D I M

Trupi gjyqësues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Roland Ilia** Kryesues  
**Genta Tafa (Bungo)** Relatore  
**Suela Zhegu** Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 3.9.2024, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Oltiana Çifliku**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, aktualisht me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.12.2020 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Suela Zhegu dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

**4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

**5.** Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

**6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

**7.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**8.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**9.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të pasurive;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** Agjencia Kombëtare për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 14.10.2022, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku.

**12.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>2</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 4.7.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 27.4.2023.

kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit në datën 5.7.2024 u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 8.7.2024, ndërsa më 22.7.2024 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

**16.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>3</sup>.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**17.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 28.8.2024.

**18.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 3.9.2024, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

**19.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur e parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i kërkoi Komisionit konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**20.** Znj. Oltiana Çifliku ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**21.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**21.1** Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>4</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë

<sup>3</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 28.8.2024.

<sup>4</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**22.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**23.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**23.1** Subjekti ka filluar detyrën në vitin 2011 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në pyetësin standard ajo ka deklaruar se ka jetuar me shtetasin L.Gj në vitet 2011 – 2017, i cili ka qenë i fejuari saj deri në vitin 2015, ndërsa në datën 29.6.2015 ka lidhur martesë. Subjekti ka deklaruar se nga muaji korrik 2017 është ndarë faktikisht me shtetasin L. Gj dhe në datën 29.5.2018 është ndarë me vendim gjykatë nr. \*\*.

**23.2** Nga vendimi i gjykatës rezulton se subjekti nuk ka kërkuar pjesëtimin e pasurisë, kjo edhe për arsyen se të gjitha pasuritë e shtetasit L.Gj janë krijuar para lidhjes së martesës, si dhe nuk kanë pasur si burim të ardhura të subjektit.

**23.3** Sipas këtij vendimi të gjykatës, shtetasi L.Gj duhet të paguajë 35,000 lekë detyrim ushqimor për djalin e tyre të mitur.

**23.4** Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

---

*i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”*

**24. Automjet tip “Daimler Chrysler”<sup>5</sup>, blerë në vlerën 2,200 euro.**

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** Të ardhurat e përfituara nga kredia bankare.

**Hetimi<sup>6</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**25.** Subjekti, me kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 2.6.2014, ka blerë automjetin tip “Daimler Chrysler”, vit prodhimi 1999, në vlerën 2,200 euro, nga e cila 400 euro është likuiduar në datën 29.5.2014 jashtë zyrës noteriale dhe 1,800 euro janë likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës.

**25.1** Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV/2014, në vlerën 2,200 euro, duke mos specifikuar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**26.** Në DPV/2014, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 1,000,000 lekë, përfituar si rrjedhojë e marrjes së kredisë bankare nga Raiffeisen Bank.

**26.1** Subjekti, në pyetësin dërguar ILDKPKI-së me *email*-in datë 18.12.2015, ka shpjeguar se kredia është marrë për arsye personale për blerjen e automjetit, si dhe për shpenzime të tjera personale.

**27.** Nga hetimi në lidhje me këtë kredi, ka rezultuar se në datën 11.7.2014 subjekti ka lidhur kontratë kredie bankare me palë kredidhënëse Raiffeisen Bank dhe palë kredimarrëse Oltiana Çifliku, për kredi në shumën 1,000,000 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë është për përdorimi personal. Afati i shlyerjes 36 muaj.

i) Nga nxjerrja e llogarisë bankare së subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se:

- a. në datën 18.7.2014 është disbursuar kredia në shumën 1,000,000 lekë;
- b. në datën 18.7.2014, subjekti transferon në llogari të shtetasit L.Gj shumën 300,000 lekë, nën komentin “Kalim në llogari” dhe tërheq *cash* shumën 70,000 lekë;
- c. në datën 1.8.2014, subjekti kalon në llogarinë e saj rrjedhëse nr. \*\*\*-ALL-\*\* shumën 550,000 lekë, nën komentin “Kalim në llogari”, si dhe tërheq *cash* shumën 120,000 lekë.

ii) Shuma 550,000 lekë rezulton se është transferuar:

- a. në llogarinë e shtetasit L.Gj, në datën 28.10.2014, në shumën 300,000 lekë;
- b. në datën 19.8.2014, në shumën 115,000 lekë, në llogarinë e shtetasit K.B (i cili është një nga ortakët e një prej shoqërive në të cilat është ortak edhe ish-bashkëshorti i subjektit);
- c. në datën 8.8.2014 është tërhequr *cash* shuma 100,000 lekë.

**28.** Për sa më sipër, duket se kredia e marrë në datën 11.7.2014 në Raiffeisen Bank nuk ka shërbyer si burim për blerjen e këtij automjeti në datën 2.6.2014. Për rrjedhojë, duket se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, ku ka deklaruar si burim kredinë e marrë në Raiffeisen Bank për blerjen e automjetit. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë gjetje.

<sup>5</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.6.2014; (ii) praktika e plotë e blerjes së automjetit në Gjermani; (iii) kontratë kredie bankare datë 11.7.2014.

<sup>6</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021; kthim përgjigjeje e ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021.

**29.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>7</sup> se të ardhurat për blerjen e këtij automjeti kanë qenë të shtetasit L.Gj dhe pasi ka marrë kredinë, sikundër rezulton, ajo menjëherë e ka transferuar shumën 300,000 lekë në llogarinë e tij bankare. Subjekti pretendon se arsyeja që ka deklaruar si burim kredinë ka qenë pikërisht ky transferim i bërë shtetasit L. Gj, me burim të ardhurat nga kredia.

**30.** Komisioni vlerëson se subjekti duhet të ishte treguar e kujdesshme në plotësimin e deklaratës *Vetting*, duke deklaruar si burim të ardhurat konkrete, të cilat kishin shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, por për sa kohë subjekti nuk rezulton me mungesë burimesh për blerjen e saj, pasi ajo dhe personi i lidhur kanë likuiditete dhe mjete financiare që kënaqin kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit<sup>8</sup>, kjo pasaktësi nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

**31.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>9</sup> lidhur me mundësinë e pagesës së shumën 400 euro në datën 29.5.2014 dhe pagesën e shumës 1,800 euro në datën 2.6.2014. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

**Në përfundim të hetimit** konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri.

**32. Nxjerrje llogarie<sup>10</sup> për llogarinë nr. AL\*\*\* në Raiffeisen Bank, në emër të subjektit Oltiana Çifliku, datë 19.1.2017**

**Hetimi<sup>11</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**33.** Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se gjendja në datën 18.1.2017 është 844.86 lekë. Në këtë llogari ish-bashkëshorti i saj depoziton pensionin ushqimor për djalin e tyre.

**33.1** Pas periudhës së rivlerësimit në këtë llogari janë disbursuar dy kredi të marra nga subjekti pranë Raiffeisen Bank, si vijon:

- me kontratë datë 24.2.2017 ajo ka marrë kredi në shumën 700,000 lekë, me afat 24 muaj;
- kredi në shumën 250,980 lekë për blerje pajisjesh (frigorifer + lavatrice), marrë në datën 5.7.2017.

**Në përfundim** konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin.

**34. Nxjerrje llogarie<sup>12</sup> për llogarinë dyemërore nr. \*\*\* në Societe Generale Albania Bank, në emër të subjektit Oltiana Çifliku dhe të ish-bashkëshortit L.Gj, datë 24.1.2017, në vlerën -150.00 lekë**

---

<sup>7</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

<sup>8</sup> Vendim nr. 31/2020.

<sup>9</sup> Shihni tabelën nr. 1 të rezultateve të hetimit.

<sup>10</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë pranë Raiffeisen Bank, datë 19.1.2017.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021.

<sup>12</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmimin nr. \*\*prot., datë 24.1.2017, nga Societe Generale Albania Bank.

## Hetimi<sup>13</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

35. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit dhe ish-bashkëshortit të saj në bankën Societe Generale Albania rezulton së gjendja në datën 26.1.2017 është 1,904.28 lekë. Në këtë llogari nuk evidentohen lëvizje me shuma për t'u konsideruar.

Në **përfundim** konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin.

## DETYRIMET FINANCIARE

36. **Kontratë kredie bankare**<sup>14</sup> pranë Raiffeisen Bank, datë 11.7.2014, në vlerën 1,000,000 ALL, me qëllim personal blerje automjeti, me datë fillimi 11.7.2014 dhe datë mbarimi 18.7.2017, me interes bazë fiks 10% për të gjithë jetëgjatësinë e kredisë, me këst mujor në vlerën 32,267.19 lekë (trajtuar në pikën 27 të këtij vendimi).

## DEKLARIM I ISH-BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT – L.GJ

### DEKLARIMI I PASURIVE

37. **Pasuri e paluajtshme tokë arë**<sup>15</sup>, me sipërfaqe 1.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin Sh, Durrës, blerë nga prindërit nëpërmjet kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme datë 25.2.2014, në vlerën 7,000,000 lekë.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** Të ardhurat e familjes.

### Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për blerjen e pasurisë tokë arë me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, në vlerën 7,000,000 lekë, datë 25.2.2014, në Sh, Durrës, nga L.Gj. Gjithashtu, është e paqartë pjesa takuese e investuar respektivisht nga L.Gj dhe familjarët e tij, për blerjen e pasurisë, deklaruar me burim nga të ardhurat e familjes.*
- *Mospërputhje e vlerës së pasurisë tokë arë me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, në Sh, Durrës, prej 70,000 euro, në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetore 2015, vlerë e cila në deklaratën Vetting dhe sipas kontratës së shitblerjes datë 25.2.2014 është 7,000,000 lekë. Gjithashtu, rezulton mosdeklarim i burimit të krijimit të pasurisë, në deklaratën periodike vjetore 2015.*

## Hetimi<sup>16</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

38. Ish-bashkëshorti i subjektit, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 25.2.2014, me palë shitëse V.Gj e Zh.Gj (prindërit e tij) dhe palë blerëse L.Gj, ka blerën pasurinë nr. \*\*, të llojit arë, me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në z. k. \*\*\*, Sh, Durrës, kundrejt shumës 7,000,000 lekë.

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e OTP-së nr. \*\*tbo- \*\* prot., datë 4.2.2021.

<sup>14</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmimin nga Raiffeisen Bank, datë 20.1.2017.

<sup>15</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitblerjeje nr. \*\* rep., nr. \*\* kol., datë 25.2.2014; (ii) kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2013; (iii) kontratë hipotekimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.; (iv) certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë arë nr. \*\*\*, me sip. 1.000 m<sup>2</sup>.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKD-së dhe UKT-së; kthim përgjigjeje e UKD-së nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar FSHU-së; kthim përgjigjeje e FSHU-së nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021; shkresë nr. \*\*\*, datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; kthim përgjigjeje e ASHK-së Durrës nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Alpha Bank nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021.



**38.1** Në kontratë përcaktohet se pasuria është e ngarkuar me barrë hipotekore në favor të BKT-së, referuar kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* rep., datë 22.4.2013. Pasuria hyn në qarkullim civil me miratim të kreditorit BKT, duke i bartur blerësit L.Gj të gjitha të drejtat/detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2013.

**38.2** Palët deklarojnë likuidimin total të çmimit, jashtë zyrës noteriale.

**39.** Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting* në lidhje me këtë pasuri, ka bashkëlidhur:

a. Kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2013, me palë kredidhënëse Banka Kombëtare Tregtare dhe palë kredimarrëse shoqëria “G” sh.p.k., me NIPT K\*\*\*F, dorëzanës L.Gj, V.Gj dhe Zh.Gj.

Sipas kësaj kontrate, shoqëria “G” sh.p.k. do të përfitojë ekuivalentin në lekë të shumës 160,000 euro, si limit *overdrafti*, për blerje inventari/kapital qarkullues, në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara nga kjo kontratë, ose si limit jo *cash* (letër kredi/garanci), sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2013.

Afati i shlyerjes së kredisë me kufi 12 muaj, me mundësi rinovimi deri në 36 muaj. Kredimarrësi kundrejt limitit total prej ekuivalentit në lekë të shumës 160,000 euro, e siguron bankën me anë të garancisë së përfaqësuar nga kontrata e hipotekimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2013.

b. Kontratë hipotekimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2013, me palë hipotekuese V.Gj, e pranishme Zh.Gj (bashkëshortja) dhe palë kreditore Banka Kombëtare Tregtare.

Në kontratë përcaktohet se hipotekuesi është pronar i pasurisë arë me sipërfaqe totale 1.000 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, Sh, Durrës. Prona do të hipotekohet në radhë të parë në favor të kreditorit BKT, për të siguruar kthimin e kredisë së marrë nga debitori, shoqëria “G” sh.p.k., në shumën totale, ekuivalentit në lekë të shumës 160,000 euro, së bashku me interesat dhe detyrimet e tjera sipas: kontratës së kredisë (me kufi) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2013; kontratës së kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2013, dhe të gjitha kreditimeve që do t’i bëhen kredimarrësit, shoqëria “G” sh.p.k., brenda limitit të aprovuar nga banka.

Sikundër rezulton, kjo pasuri duket se është përdorur për qëllim të aktivitetit tregtar të ish-bashkëshortit të subjektit dhe nuk është përdorur asnjëherë nga ana e saj. Ky konstatim do të mbahet në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

**40.** Nga hetimi ka rezultuar se:

- i) ASHK Durrës konfirmon në emër të shtetasit L.Gj pasurinë arë, ndodhur në z. k. \*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*\*, përfituar me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 25.2.2014. Kjo pasuri bazuar në kartelën e pasurisë fillimisht është blerë nga babai i ish-bashkëshortit të subjektit për shumën 7,000,000 lekë, me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.11.2006.
- ii) Ish-bashkëshorti i subjektit ka paraqitur kërkesë pranë Ujësjellës-Kanalizime Durrës në datën 12.11.2014, për furnizim me ujë për objektin banesë 4 kate, ndodhur në fshatin Sh, komuna Rr. Bashkëlidhur kërkesës ndodhet edhe dokumenti i identifikimit të ish-bashkëshortit të subjektit.

iii) Ka mospërputhje të vlerës së pasurisë tokë arë, e deklaruar 70,000 euro, në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2015, vlerë e cila në deklaratën *Vetting* dhe sipas kontratës së shitblerjes datë 25.2.2014 është 7,000,000 lekë.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 4.4.2024, ka sqaruar se pas komunikimit me ish-bashkëshortin, shtetasin L.Gj, i ka shpjeguar që deklarimi i mësipërm është lapsus nga ana e tij, në kushtet kur për një kohë të gjatë ka jetuar në Francë dhe ishte mësuar të komunikonte në valutën euro, prandaj dhe është deklaruar si e tillë.

**41.** Komisioni ka hetuar në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie. Nga ky hetim ka rezultuar se:

i) QKB-ja<sup>17</sup> informon se:

a. L.Gj (ish-bashkëshorti) rezulton:

- të ketë qenë administrator (2014 – 2019) dhe është ortak i vetëm në shoqërinë “G” sh.p.k., i regjistruar në datën 26.12.2007, me NIPT K\*\*\*F;
- ortak zotërues i 40.5% të kuotave në shoqërinë “\* AL” sh.p.k., i regjistruar në datën 16.4.2013, me NIPT L\*\*\*R;
- të ketë qenë administrator (2010 – 2013) dhe është ortak zotërues i 50% të kuotave në shoqërinë “A” sh.p.k., regjistruar në datën 18.11.2010, me NIPT L\*\*\*A;
- person fizik, regjistruar në datën 13.3.2012, me NIPT L\*\*\*T;
- të ketë qenë administrator dhe është ortak zotërues i 5% të kuotave në shoqërinë “B” sh.p.k., regjistruar në datën 21.5.2009, me NIPT K\*\*\*R. Subjekti është me status “pezulluar” prej datës 12.9.2013;
- të ketë qenë administrator dhe është ortak zotërues i 50% të kuotave në shoqërinë “P” sh.p.k., regjistruar në datën 18.3.2009, me NIPT K\*\*\*D. Aktualisht ky subjekt është me status “shoqëri në likuidim e sipër”.

b. V.Gj (ish-vjehri) figuron:

- të ketë qenë administrator dhe është ortak i 33.33% të kuotave në shoqërinë “M.R.E-T” sh.p.k., regjistruar në datën 19.12.2008, me NIPT K\*\*\*H. Aktualisht subjekti rezulton me status “shoqëri në likuidim e sipër”;
- të ketë qenë administrator (2011 – 2016) dhe ortak i vetëm në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., regjistruar me vendim gjykatë nr. \*\*\*, datë 15.6.1994, me NIPT J\*\*\*E. Aktualisht subjekti është me status “pezulluar”;
- të ketë qenë administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “G” sh.p.k., larguar në datën 9.8.2011.

c. Zh.Gj (ish-vjehrra) figuron të kenë qenë administratore në shoqërinë “G” sh.p.k., larguar në datën 12.9.2014.

ii) DRT Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021, informon se:

a. V.Gj figuron i regjistruar si aksioner dhe administrator në subjektin “M.R.E-T” sh.p.k., prej datës 19.12.2008. Subjekti ka dorëzuar deklarata tatim-fitimi për periudhën 2009 – 2014, në të cilën xhiroja e deklaruar ka qenë 0 (zero) lekë, ndërsa për vitin 2011 rezulton me humbje në shumën 600,000 lekë dhe për vitin 2012 humbje në vlerën

---

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021.

771,506 lekë. Subjekti ka gjoba në sistemin informatik në shumën 210,000 lekë dhe rezulton me status “pasiv” prej datës 18.12.2014.

- b. L.Gj figuron i regjistruar me NIPT L\*\*\*T, person fizik, aktivitet “kafene” nga data 13.3.2012, nuk ka kryer asnjë deklaram në sistemin tatimor dhe ka gjoba në sistemin informatik në shumën 35,000 lekë. Subjekti rezulton me status “pasiv” prej datës 22.12.2014.

iii) DRT Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021, konfirmon se:

- a. V.Gj figuron i regjistruar si tatimpagues në subjektin “\*\*\*”, me NIPT J\*\*\*E. Gjatë periudhës 1996 – 2012 është deklaruar fitim në shumën totale prej 47,755,835 lekësh, ndërsa për vitin 2013 deklaroi humbje në vlerën 2,786.180 lekë. Në deklaratën e vitit 2014 deklaroi xhiro në vlerën 145,900 lekë dhe fitim në vlerën 124,015 lekë. Në deklaratat e viteve 2015 – 2016 deklarohet xhiro/fitim 0 (zero) lekë. Subjekti nuk ka shpërndarë dividend dhe ka detyrime në total në vlerën 2,413,661 lekë.
- b. L.Gj figuron i regjistruar pranë subjektit “G” sh.p.k., me NIPT K\*\*\*F. Për periudhën 2008 – 2016 ka deklaruar fitim, si vijon:

| Viti             | Fitimi     |
|------------------|------------|
| 2008             | 124,496    |
| 2009 – 2010/2016 | 0          |
| 2011             | 2,134,033  |
| 2012             | 14,865,591 |
| 2013             | 14,236,777 |
| 2014             | 1,439,921  |
| 2015             | 83,082     |
| 2016             | 285,768    |

Nga të dhënat rezulton që nuk është paguar dividend. Subjekti ka detyrime në shumën 19,800,588 lekë.

- c. L.Gj figuron i regjistruar si administrator i aktivitetit tregtar në shoqërinë “\*\*\*”, me NIPT L\*\*\*R. Subjekti ka deklaruar për vitet 2013 – 2016 si vijon:

| Viti | Fitimi/humbje |
|------|---------------|
| 2013 | -1,245,094    |
| 2014 | 6,166,973     |
| 2015 | -1,882,474    |
| 2016 | 424,628       |

Subjekti nuk ka shpërndarë dividend dhe ka detyrime në shumën 20,186 lekë.

- d. L.Gj figuron administrator i aktivitetit tregtar “A”, me NIPT L\*\*\*A, me status “pasiv” prej datës 16.12.2014. Subjekti ka deklaruar fitim të tatuëshëm për vitin 2012 në vlerën 262,932 lekë dhe për vitin 2013 në vlerën 134,345 lekë. Për vitin 2014 deklaroi humbje në vlerën 2,434,959 lekë. Subjekti nuk ka shpërndarë dividend.
- e. L.Gj figuron administrator në subjektin “P”, me NIPT K\*\*\*D, me status “pasiv” prej datës 6.5.2016. Referuar të dhënave që disponohen nga pasqyrat financiare të vitit 2011, të ardhurat janë deklaruar në vlerën 0 (zero) lekë. Subjekti nuk ka kryer deklarime të tjera. Detyrimet janë në shumën 131,503 lekë.

- f. L.Gj figuron administrator në subjektin “B”, me NIPT K\*\*\*R, me status “pasiv” prej datës 26.12.2016. Referuar të dhënave që disponohen, subjekti rezulton mosdeklarues i të ardhurave dhe ka detyrime në vlerën 936,052 lekë.

Për sa më sipër, rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit dhe babai i tij kanë kryer aktivitet tregtar me xhiro dhe fitim të konsiderueshëm, fakt i cili provohet edhe nga nxjerrjet e llogarive bankare, por për sa kohë nuk rezulton të jetë shpërndarë dividend, këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizë financiare, por do të mbahen në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

**42.** Komisioni, për një hetim sa më të plotë, i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me këtë pasuri të ish-bashkëshortit të saj. Në pyetësonin nr. 1, datë 4.4.2024, subjekti ka deklaruar se: *“...kjo pasuri është krijuar përpara njohjes dhe martesës time me ish-bashkëshortin, shtetasin L.Gj, pasuria e mësipërme është pasuri vetjake e ish-bashkëshortit, fituar nga ana e tij para martesës. Sa më sipër, sikurse rezulton edhe nga vendimi i zgjidhjes së martesës<sup>18</sup>, nuk është kërkuar dhe as pretenduar ndarja e saj nga ana ime gjatë procesit gjyqësor, prandaj kjo pasuri nuk i është nënshtruar pjesëtimit. Pasuria e mësipërme është blerë nga ish-vjehrrin, shtetasi V. Gj, nëpërmjet kontratës së shitjes me rezervë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.9.2006 dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave të saj janë të ardhurat e përftuara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me ortak dhe administrator të vetëm shtetasin V.Gj dhe nga kontrata e kredisë bankare të Alpha Bank, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.10.2006... ish-bashkëshorti im shtetasi L.Gj nuk ka pasur mundësi objektive për ta blerë këtë pasuri, pasi ka qenë ende me studime në vitin 2006 kur është blerë kjo pronë... Ish-bashkëshorti më ka shpjeguar që kjo pasuri nuk është përdorur dhe nuk përdoret as aktualisht, por mbi të babai i tij, shtetasi V.Gj, ka ndërtuar një banesë, e cila është investuar nga shtetasi francez P.P. Pas komunikimit me ish-vjehrrin tim, shtetasin V. Gj, më ka shpjeguar se ai ka ndërtuar një banesë 3-katëshe mbi pasurinë tokë arë me nr. \*\*, ndodhur në zonën kadastrale nr. \*\*, volumi \*\*, faqe \*\*, mbi bazën e investimit të shtetasit francez P.P.*

*Ai sqaron që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ku ai ka qenë ortak dhe administrator i vetëm, ka pasur marrëdhënie tregtare me kompaninë “\*\*\*\*” të shtetasit P.P nga data 5.8.1992 deri në gusht të vitit 2002. Për të kryer këto punime sqaron se ka marrë leje sheshi ndërtimi dhe ka lidhur kontratë sipërmarrjeje në vitin 2009 për ndërtimin e objektit.*

*Burimi i të ardhurave për këtë investim janë të ardhurat e dërguara me transfertë bankare nisjeje me swift nga urdhëruesi “\*\*\*\*” sh.p.k., Plepa, Durrës dhe konkretisht nga investitori P. P, i cili zotëron 95% të kapitalit themeltar në shoqërinë “\*\*\*\*”.*

**43.** Bashkëlidhur pyetësorit subjekti ka paraqitur:

i) Kontratë shitjeje me rezervë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.9.2006, sipas së cilës shtetasi A.Gj i shet palës blerëse V.Gj pasurinë arë me sipërfaqe 1.000 m<sup>2</sup>, në Sh, zona kadastrale \*\*\*, nr. i pasurisë \*\*\*. Çmimi i shitjes është 7,000,000 lekë dhe pagesa do të bëhet me këste: kësti i parë prej 2,000,000 lekësh do të likuidohet në datën 30.9.2006; kësti i dytë prej 5,000,000 lekësh do të likuidohet në datën 30.10.2006.

---

<sup>18</sup> Vendim nr. (11-2018-2704) 910, datë 29.5.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “Zgjidhje martesë ndërmjet palës paditëse Oltiana Çifliku dhe palës së paditur L.Gj”.

Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se nga nxjerrja e llogarisë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në Raiffeisen Bank rezulton se në datën 2.10.2006 është kryer një pagesë në shumën 2,000,000 lekë për shtetasin A.Gj, me emërtimin “Blerje toke sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.9.2006.

ii) Kontratë kredie shërbyer me llogarinë rrjedhëse nr. \*\*\*, datë 27.10.2006, nëpërmjet së cilës Alpha Bank i ka çelur kredimarrësit “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator shtetasin V.Gj, kredi në shumën 290,000 euro.

iii) Marrëveshje shtesë nr. \*\*\*, datë 27.10.2006, e kontratës së kredisë së mësipërme, sipas së cilës në nenin 4 është përcaktuar së kredia do të përdoret për kapital qarkullues.

iv) Vendim i ortakut të vetëm të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku është vendosur marrja e kredisë në shumën 290,000 euro për nevoja të shoqërisë.

v) Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 31.10.2006, nëpërmjet së cilës shtetasi A.Gj deklaroi se: *“Shtetasi V.Gj, sot, në datën 31.10.2006, i ka likuiduar shumën 7,000,000 lekë, çmimi total i shitjes së tokës arë sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.9.2006”.*

vi) Dokument në anglisht i shoqërisë “\*\*\*\*”, ku në pjesën e vërtetimit-përkthimit përshkruhet fakti që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka pasur marrëdhënie tregtare me shoqërinë “\*\*\*\*” nga data 5.8.1992 deri në gusht të vitit 2002.

vii) Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.4.2024, e shtetasit V.Gj, në të cilën deklaroi se: *“Në vitin 1997 kam blerë terren 6.500 m<sup>2</sup> në fshatin P, me çmim 300 lekë/m<sup>2</sup> dhe rreth vitit 1999/2000 kam filluar ndërtimin e objektit me të ardhura nga fitimi i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe kredi bankare të marrë në Alpha Bank. Ky ndërtim ka zgjatur deri në vitin 2014, ku me dokumentacion të rregullt ia kam kaluar djalit L.Gj për efekt legalizimi. Lidhur me objektin e dytë me terren 1.000 m<sup>2</sup>, në A, Durrës, edhe ky terren është blerë nga unë, për blerjen e të cilit janë përdorur fitimet e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe kredia bankare. Mbi këtë objekt është ndërtuar një banesë 3-katëshe, me investitor një shtetas francez P.P. Terreni prej 1.000 m<sup>2</sup> ia kam kaluar në pronësi djalit L.Gj”.*

viii) Vendim i KRRT-së nr. \*\*\*, datë 25.10.2009, për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij, sipas të cilit është miratuar ndërtimi i objektit 2 kat + bodrum + papafingo + pishinë për shtetasin V.Gj, sipërfaqja e sheshit 1.000 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e ndërtimit 300 m<sup>2</sup>, së bashku me:

- leje ndërtimi lëshuar subjektit ndërtues “V-G” për kompleks vilash;
- preventiv punimesh suvatim në vlerën 2,652,284 lekë;
- preventiv punimesh soleta shtesë dhe shkallët në vlerën 1,238,286 lekë;
- analiza kostosh për punimet për metër katror;
- akt themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “B” sh.p.k.

ix) Transfertë bankare me *swift* në vlerën 199,500 euro nga shoqëria “B” sh.p.k.

x) Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 7.10.2009, ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “U.K” sh.p.k., Sarandë, me administrator shtetasit Th.G dhe shtetasin V.Gj për ndërtimin e një vile 2 kate + bodrum, me çmim 9,069,000 lekë.

**44.** Komisioni, bazuar në shpjegimet e subjektit, ka verifikuar llogaritë bankare të shoqërisë “B” sh.p.k., nga ku rezulton se:

a. Nga nxjerrja e llogarisë së shoqërisë “B” sh.p.k. në euro në Alpha Bank provohet se për llogari të shoqërisë “U.K” janë transferuar shumat si vijon:

- në datën 25.11.2009 shuma 6,500 euro, me emërtimin “Diferencë pagesë kësti i parë + pagesë shtesë kati përdhe”;
- në datën 8.1.2010, shuma 10,000 euro, me emërtimin “Likuidim detyrimi”;
- në datën 8.3.2010, shuma 4,700 euro;
- në datën 27.4.2010, shuma 10,000 euro.

**Në total shuma 31,200 euro.**

b. Nga nxjerrja e llogarisë së shoqërisë “B” sh.p.k. në lekë, në Alpha Bank, rezulton se për llogari të shoqërisë “U.K” janë transferuar shumat si vijon:

- në datën 9.10.2009, shuma 2,700,000 lekë, me emërtimin “Likuidim sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 7.10.2009”;
- në datën 18.1.2010, shuma 1,000,000 lekë;
- në datën 25.1.2010, shuma 2,765,000 lekë;
- në datën 12.2.2010, shuma 1,000,000 lekë;
- në datën 25.2.2010, shuma 346,000 lekë.

**Në total shuma 7,811,000 lekë.**

**45.** Komisioni, bazuar në shpjegimet e subjektit, si dhe provat e paraqitura prej saj, por edhe nga hetimi, konstaton se në pasurinë tokë arë të deklaruar në deklaratën *Vetting* është ndërtuar një banesë trekatëshe nga ana e babait të ish-bashkëshortit të saj. Në lidhje me këtë ndërtesë, ish-bashkëshorti i subjektit dhe babai i tij kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 19.2.2014, në të cilën shtetasi V.Gj, deklaroi se është ngarkuar nga djali i tij L.Gj për të ndjekur të gjitha punimet e ndërtesës së banimit, e cila është në pronësi të këtij të fundit.

**45.1** Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj ndërtese, provohet që pagesat janë kryer nga ana e shoqërisë “B” sh.p.k. përpara marrjes së detyrës së subjektit dhe përpara se të martohej.

**46.** Në përfundim, në lidhje me pasurinë e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se:

- a. kjo pasuri është krijuar para martesë dhe para detyre;
- b. pagesat për krijimin e saj janë bërë nga llogaritë bankare të shoqërive tregtare të ish-bashkëshortit të subjektit dhe babait të tij;
- c. nuk është përdorur asnjëherë nga subjekti;
- d. është lënë si garanci për garantimin e detyrimeve të ish-bashkëshortit dhe të shoqërive të tij;
- e. pas zgjidhjes së martesës nuk rezulton të jetë pjesëtuar apo subjekti të ketë pretenduar pjesë takuese në këtë pasuri,

– Komisioni vlerëson se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e saj, ndërkohë që iu kërkuan shpjegime në lidhje me faktin se:

- i. Ish-bashkëshorti i saj nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* ndërtesën e ndodhur në pasurinë tokë arë, për të cilën ka kryer edhe aplikim për furnizimin me ujë.

- ii. Ka mospërputhje të vlerës së pasurisë tokë arë, pasi në deklaratën e interesave private periodikë vjetorë 2015 është deklaruar në shumën 70,000 euro, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* dhe në kontratën e shitblerjes vlera është 7,000,000 lekë.

**47.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>19</sup> se: “Ky objekt nuk ka qenë dhe nuk është në pronësi të ish-bashkëshortit tim, shtetasit L.Gj, prandaj rrjedhimisht nuk është deklaruar nga ana e tij në deklaratën *Vetting*. Sikurse rezulton edhe nga hetimi administrativ, investitori për kryerjen e objektit (vilë me tre kate) është shtetasi francez P.P, i cili është edhe aksioneri prej 95% të kuotave të shoqërisë “B” sh.p.k., shoqëri e cila ka kryer edhe pagesat për investimin dhe krijimin e këtij objekti.

*Ish-vjehri im, shtetasi V.Gj dhe ish-bashkëshorti im, shtetasi L.Gj, kanë administruar kryerjen e shërbimeve në ndërtesë për llogari të shtetasit P.P. Ish-bashkëshorti më ka sqaruar se në kushtet kur objekti ka edhe një pishinë pjesë përbërëse të tij, në kuadër të administrimit për kryerjen e shërbimeve për këtë objekt në mënyrë që të përfundonte ndërtimi i pishinës dhe të bëhej funksionale, ai ka kryer aplikimin për furnizimin me ujë. Nga ana tjetër, sikurse rezulton edhe ish-vjehri, shtetasi V.Gj gjithashtu në kuadër të administrimit për kryerjen e shërbimeve të objektit ka kryer aplikimin për furnizimin me energji elektrike për të njëjtin objekt, ku rezulton të jetë hapur kontrata me nr. A\*\*\* në emër të shtetasit V.Gj... Fakti që shtetasi francez P.P është investitor i ndërtimit provohet edhe nga hetimi administrativ dhe nga vetë konstatimet e Komisionit, sipas të cilit rezulton se burimi i krijimit të kësaj ndërtese provohet se janë pagesat e kryera nga ana e shoqërisë “B” sh.p.k. përpara marrjes së detyrës së subjektit dhe përpara se ajo të marrohej. Gjithashtu, po nga hetimi rezulton se pagesa për ndërtimin e objektit janë kryer edhe në llogarisë rrjedhëse në monedhën euro të ish-bashkëshortit në Alpha Bank, nr. AL\*\*\*, nga shtetasi P.P, i cili ka transferuar shumat e mëposhtme:*

- në datën 20.5.2011, shtetasi P.P ka transferuar shumën 25,000 euro;
- në datën 8.7.2011, shtetasi P.P ka transferuar shumën 35,000 euro;
- në datën 19.12.2016, shtetasi P.P ka transferuar shumën 2,000 euro, me emërtim “Për shpenzimet e vilës”.

*Sa më sipër, rezulton e qartë se në përshkrimin e veprimtimit bankar të datës 19.12.2016, se shuma 2,000 euro është dërguar nga investitori, shtetasi P.P, me qëllim përdorimin për shpenzimet e vilës, konkretisht objektit të ndërtuar mbi pasurinë tokë arë me nr. \*\*\* dhe me sipërfaqe 1.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në z. k.\*\*\*, Sh, sikurse e kam shpjeguar edhe në përgjigjet e pyetësorit të parë, por referuar edhe deklaratës noteriale të ish-bashkëshortit, të datës 17.7.2024, sqaroj se deklarimi në DPV/2015 është lapsus nga ana e tij, në kushtet kur për një kohë të gjatë kishte jetuar në Francë dhe ishte mësuar të komunikonte në valutën euro, shtuar këtu faktin që deklarimi në DPV/2015 si person i lidhur ishte deklarimi i tij i parë dhe ai nuk ishte i mësuar me procedurën e deklarimit, prandaj ka neglizhuar të konsultohet me dokumentacionin e shitblerjes së tokës”.*

**48.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, duke marrë në konsideratë faktet e mëposhtme:

- a. ndërtimi provohet të jetë paguar nga llogaritë shoqërisë “B” sh.p.k., ku ortak me 95% të pjesës takuese është shtetasi P.P. Gjithashtu, provohet që ky shtetas ka transferuar gjatë

---

<sup>19</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

- periudhës së ndërtimit, si dhe pas saj, shuma të konsiderueshme në llogari të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ku në një ndër to ka specifikuar edhe faktin që shërbejnë për shpenzimet e vilës;
- b. ndërtesa dhe toka provohet se janë krijuar në një kohë kur subjekti nuk ishte në detyrë dhe nuk ishte e martuar;
  - c. pasaktësitë në deklaratën *Vetting* janë bërë nga ish-bashkëshorti i saj;
  - d. këto pasaktësi nuk shoqërohen me mungesë burimesh të ligjshme, pasi provohet burimi i ligjshëm për blerjen e tyre;
  - e. subjekti nuk e ka përdorur asnjëherë këtë pasuri;
  - f. kjo pasuri, siç rezulton nga hetimi i Komisionit, është përdorur për interesa të aktivitetit tregtar të ish-bashkëshortit të saj;
  - g. kjo pasuri vijon të jetë në pronësi individuale të ish-bashkëshortit të subjektit, pasi ajo është krijuar para martesës ligjore dhe bazuar në nenet 74 dhe 77 të Kodit të Familjes ajo nuk është pjesë e bashkësisë ligjore;
  - h. për këtë pasuri rezulton e provuar se është paguar shuma e blerjes prej 7,000,000 lekësh, shumë e cila është deklaruar saktë në deklaratën *Vetting*,
- Vlerëson se në lidhje me këtë pasuri, pavarësisht faktit se nga ana e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është bërë një deklaram i pasaktë në deklaratën *Vetting*, për sa kohë ky deklaram nuk shoqërohet me mungesë burimesh për krijimin e pasurisë, ai nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të subjektit. Gjithashtu, në lidhje me deklaramin e çmimit në vitin 2015, ai përbën një pasaktësi në deklaratën periodike dhe nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>20</sup>.

**49. Pasuria e paluajtshme tokë arë<sup>21</sup>**, me sipërfaqe totale 6.940 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin P, komuna Xh, Durrës, blerë nëpërmjet kontratave të shitblerjeve të pasurive të paluajtshme të vitit 2013, në vlerën totale të çmimit të blerjes 2,436,760 lekë.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** Të ardhurat e familjes.

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së**

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për blerjen në vitin 2013 nga L.Gj të pasurisë tokë arë me sipërfaqe totale 6.940 m<sup>2</sup>, në vlerën 2,436,760 lekë, në P, Durrës. Gjithashtu, është e paqartë pjesa takuese e investuar respektivisht nga L.Gj dhe familjarët e tij për blerjen e pasurisë, deklaruar me burim nga të ardhurat e familjes.*

**50. Objekti aktivitet (magazinë)<sup>22</sup>**, 1 - 2 kate, me sipërfaqe totale ndërtimi 2.853 m<sup>2</sup>, legalizuar në vitin 2014 me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 17.7.2014, të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Durrës.

**Burimi sipas deklaratës *Vetting*:** Të ardhurat e familjes.

<sup>20</sup> Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit.

<sup>21</sup> Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar: (i) certifikatë për vërtetim pronësie datë 18.8.2014; (ii) kontratë shitblerjeje toke arë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.6.2013; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie datë 4.9.2013; (iv) kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2013; (v) certifikatë për vërtetim pronësie datë 28.8.2013; (vi) kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2013.

<sup>22</sup> Bashkëlidhur deklaratës: (i) leje legalizimi datë 17.7.2014; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie datë 18.8.2014.



## **Konstatimi i ILDKPKI-së**

- *Mosdeklarim i vlerës së investimit dhe periudhës së ndërtimit të objektit magazinë 1-2 kate, me sipërfaqe totale ndërtimi 2.853 m<sup>2</sup>, në Xh, Durrës, legalizuar në vitin 2014.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor (preventiv, situacion punimesh etj.) lidhur me ndërtimin e objektit magazinë 1-2 kate me sip. 2.853 m<sup>2</sup>, në Xh, Durrës, legalizuar në vitin 2014.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimin për ndërtimin e objektit magazinë 1-2 kate me sipërfaqe totale ndërtimi 2.853 m<sup>2</sup>, në Xh, Durrës.*
- *Konstatohet se burimi i krijimit të pasurisë magazinë 1-2 kate me sip. 2.853 m<sup>2</sup> në deklaratën Vetting deklarohet nga të ardhurat e familjes nga puna me biznes ndër vite, ndërsa sipas deklaratës noteriale datë 29.8.2013, vlera e investimit për ndërtimin e magazinës është kryer totalisht nga L.Gj.*
- *Është i paqartë fakti se ndërtimi i katit të parë të magazinës në Xh, Durrës, është bërë në vitin 2000 nga babai V.Gj, ndërsa toka mbi të cilin është ndërtuar magazina është blerë në vitin 2013 nga bashkëshorti L.Gj.*

## **Hetimi<sup>23</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

### **51. Ish-bashkëshorti i subjektit, me:**

- a. kontratë shitblerjeje toke arë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.6.2013, ka blerë pasurinë arë me sipërfaqe 3.350 m<sup>2</sup>, në P, Durrës, regjistruar me nr. \*\*\*, kundrejt vlerës 1,135,000 lekë;
- b. kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2013, ka blerë pasurinë arë me sipërfaqe 2.900 m<sup>2</sup>, në P, Durrës, regjistruar me nr. \*\*\*, kundrejt vlerës 983,100 lekë;
- c. kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2013, ka blerë pasurinë arë me sipërfaqe 940 m<sup>2</sup>, në P, Durrës, regjistruar me nr. \*\*\*, kundrejt vlerës 318,660 lekë.

**52.** Në lidhje me këto pasuri, subjekti në pyetësin e datës 4.4.2024 ka sqaruar se: *“Pas komunikimit me ish-bashkëshortin, shtetasin L.Gj, më ka shpjeguar që pasuria e mësipërme tokë arë është blerë nga babai i tij, shtetasi V.Gj, që në vitin 1997 dhe është paguar nga ai që në këtë vit. Në këtë vit ish-bashkëshorti im ka qenë i mitur dhe nuk ka pasur mundësi efektive në krijimin e të ardhura dhe nuk ka kontribuar në blerjen e tokës. Për shkak të situatës social-ekonomike në Shqipëri nuk është bërë i mundur formalizimi i shitjes në vitin 1997, por është kryer nëpërmjet kontratave noteriale të vitit 2013.*

*Ky fakt konfirmohet edhe nga deklaratat noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.4.2024, e shtetasit V.Gj, ku ai konfirmon se pasurinë e mësipërme e ka blerë ai dhe si burim krijimi kanë qenë të ardhurat e përftuara nga shoqëria “\*\*\*”...Ai ka sqaruar se vlera e blerjes së tokës në atë kohë ka qenë minimale, rreth 300 lekë/m<sup>2</sup> dhe të ardhurat e përftuara nga shoqëria e tij*

---

<sup>23</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKD-së dhe UKT-së; kthim përgjigjeje e UKD-së nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar FSHU-së; kthim përgjigjeje e FSHU-së nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; kthim përgjigjeje e ASHK-së Durrës nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2021; kthim përgjigjeje datë 13.5.2024 e noterit publik B.Ç.

*tregtare kanë qenë shumë më të larta... Magazina është ndërtuar nga ish-vjehri, i cili ka filluar punimet në vitet 1999 – 2000 dhe ka përfunduar në vitin 2014. Pas vitit 2014 nga ish-vjehri im nuk janë kryer më investime, por ai ia ka kaluar ish-bashkëshortit tim në mënyrë që objekti të përdorej për qëllimet e biznesit, derisa është sekuestruar nga BKT-ja për mospagim detyrimi.*

*Nuk jam në dijeni se cili është pronari aktual i kësaj pasurie. Me qëllim marrjen e informacionit, kam komunikuar me ish-bashkëshortin tim, shtetasin L.Gj, i cili më ka shpjeguar që për shkak të detyrimeve që ai kishte pasuria e mësipërme i është sekuestruar dhe më pas shitur në ankand dhe pronari aktual i kësaj shoqërie është shtetasi R.Xh”.*

**52.1** Subjekti ka bashkëlidhur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 4.9.2013, sipas së cilës shtetasi I.M deklaron se me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.6.2013, i ka shitur shtetasit L.Gj pasurinë nr. \*\*\*, me sipërfaqe 3.350 m<sup>2</sup>. Duke qenë se në sipërfaqen e kësaj pasurie janë përfshirë 250 m<sup>2</sup> tepër, është dakord që të hiqen. Ish-bashkëshorti i subjektit ka shprehur dakordësinë e tij që toka të regjistrohet me sipërfaqe 3.100 m<sup>2</sup>, duke mos u përfshirë 250 m<sup>2</sup>.

**53.** Komisioni, në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e pasurive të mësipërme, si dhe kohën e blerjes së tyre (pavarësisht se është e vërtetë që mbi këto pasuri është ndërtuar magazina nga ana e shtetasit V.Gj duke filluar nga viti 2000), do të referohet në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ASHK Durrës, nga ku rezulton se këto pasuri janë blerë në vitin 2013, periudhë në të cilën subjekti nuk ka qenë ende e martuar me ish-bashkëshortin. Ish-bashkëshorti nuk ka sqaruar në deklaratën *Vetting* se këto pasuri janë blerë në vitin 1997, sikundër pretendon subjekti. Për sa i përket burimit të të ardhurave, sikundër është trajtuar gjerësisht në pikën 41 të këtij vendimi, rezulton se pavarësisht faktit se ish-bashkëshorti i subjektit dhe babai i tij kanë pasur qarkullim dhe fitim të konsiderueshëm, për sa kohë nuk është shpërndarë dividend, të ardhurat nga këto aktivitete nuk mund të konsiderohen të ligjshme.

**54.** Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e blerjes së këtyre pasurive në vitin 2013<sup>24</sup>, nga e cila duket se ish-bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën 2,865,184.16 lekë.

**55.** Gjithashtu, Komisioni ka kryer një analizë financiare<sup>25</sup> për të parë mundësinë për kursim të prindërve të ish-bashkëshortit të subjektit për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2013, nga e cila duket se ata nuk kanë pasur mundësi kursimi të të ardhurave të ligjshme në shumën 2,439,693.08 lekë.

**56.** Në datën 15.8.2014, ish-bashkëshorti i subjektit ka bërë kërkesë për bashkimin e pasurive të regjistruara në emër të tij: nr. \*\*\* me sip. 3.100 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\* me sip. 2.900 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\* me sip. 940 m<sup>2</sup>. Pas miratimit të kërkesës, të tria pasuritë janë transkriptuar në pasurinë nr. \*\*\*.

**57.** ASHK Drejtoria Rajonale Durrës, me *email*-in e datës 21.1.2020 (gjendur në dosjen e ILDKPKI-së) konfirmon se shtetasi V.A.Gj rezulton aplikues në procesin e legalizimit me anë të vetëdeklarimit nr. \*\*\*, datë 24.11.2006, për legalizim të objektit magazinë, viti i ndërtimit

<sup>24</sup> Shihni tabelën nr. 2 të rezultateve të hetimit.

<sup>25</sup> Shihni tabelën nr. 3 të rezultateve të hetimit.

2000, në Xh, Durrës. Sipërfaqja e zënë 12.000 m<sup>2</sup>, sipërfaqja e ndërtimit 600 m<sup>2</sup>, numri i kateve mbi tokë 1.

**58.** Në datën 17.7.2014 është lëshuar leja e legalizimit në emër të ish-bashkëshortit të subjektit, për objektin “aktivitet 1-2 kat”, në komunën Xh, Durrës, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 3.328 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 2.853 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale për aktivitet 3.301,5 m<sup>2</sup>. Numri i kateve mbi tokë 2.

**59.** Bazuar në certifikatën e pronësisë rezulton se pasuria nr. \*\*\* e llojit arë + truall, ndodhur në P, Durrës, me sipërfaqe totale 6.940 m<sup>2</sup>, përbëhet nga truall me sip. 3.328 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 2.853 m<sup>2</sup>. Në seksionin e përshkrimit të veçantë të kartelës së pasurisë evidentohet objekti 1-2 kat, me sipërfaqe ndërtimi kati përdhe 2.853 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe kati përdhe 448.5 m<sup>2</sup>.

**60.** Në lidhje me pasurinë magazinë, për sa kohë rezulton e provuar se ajo është ndërtuar në vitin 2000, kohë në të cilën subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe as e martuar me ish-bashkëshortin e saj, Komisioni nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi subjektin për burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

**61.** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ASHK Durrës rezulton se pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, është nxjerrë në ankand për ekzekutimin e titullit ekzekutiv/deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 4.4.2017, me kreditor shtetasin R.Xh dhe debitor ish-bashkëshortin e subjektit. Në ankandin e tretë kjo pasuri është blerë nga shtetasi R.Xh për vlerën 57,879,200 lekë. Në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 4.4.2017, ish-bashkëshorti i subjektit deklaroi se i ka marrë hua<sup>26</sup> shtetasit R.Xh shumën 290,000 euro, ku përfshihet edhe vlera 50,000 euro e 33.3% të kuotave të shoqërisë “G.G” sh.p.k., që do të kalojnë në favor të tij.

**62.** Në lidhje me dy pasuritë e mësipërme të paluajtshme, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka firmosur në kontratat e hipotekimit<sup>27</sup> të këtyre pasurive në cilësinë e bashkëshortes, si vijon:

i) Kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 29.2.2016, lidhur me BKT-në, sipas së cilës ka firmosur në cilësinë e bashkëshortes së shtetasit L.Gj për vënien në hipotekë të pasurisë nr. \*\*\* për sigurimin e kredisë së marrë nga shoqëria “G” sh.p.k.

ii) Kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 29.2.2016, lidhur me BKT-në, sipas së cilës ka firmosur në cilësinë e bashkëshortes së shtetasit L.Gj për vënien në hipotekë të pasurisë nr. \*\*\* për sigurimin e kredisë së marrë nga shoqëria “G” sh.p.k.

**63.** Në përfundim, duket se ish-bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurive tokë bujqësore, për sa kohë nuk provohet pagimi i detyrimeve tatimore nga aktiviteti i tij dhe i babait të tij.

**64.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>28</sup> se: “Sikurse kam deklaruar edhe një pyetësorin nr. 1 të datës 4.4.2024, çmimi i pasurisë tokë bujqësore arë me sipërfaqe totale 6.940 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin P, komuna Xh, është paguar nga ish-vjehri, shtetasi V.Gj, shumë vite para se unë të njihesha me ish-bashkëshortin tim dhe para se të filloja detyrën. Ish-bashkëshorti im nuk ka asnjë kontribut në blerjen e kësaj pasurie, pasi në atë kohë ka qenë rreth 11 vjeç. Gjithashtu, ju bëj me dije se pasuria e mësipërme nuk është përdorur asnjëherë

<sup>26</sup> Kontrata e huas është lidhur në datën 20.3.2017.

<sup>27</sup> Kthim përgjigjeje datë 13.5.2024 e noterit publik F.A.

<sup>28</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

nga ana ime dhe nuk kam pasur asnjëherë interesa të ligjshme mbi të. Kjo pasuri tokë bujqësore me sipërfaqe totale 6.940 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin P, komuna Xh, Durrës, de facto është blerë dhe likuiduar rreth viteve 1996 – 1997 nga ish-vjehri im, shtetasi V.Gj, por në kushtet kur nuk ishin realizuar procedurat ligjore për kalimin e pronësisë, formalizimi i marrëveshjes së shitjes i vitit 1997 është kryer nëpërmjet 3 kontratave noteriale të shitblerjes të vitit 2013, ku palët shitëse I.M dhe S.M me marrëveshje me palën blerëse, ish-vjehrin tim, shtetasin V.Gj, kanë rënë dakord që pronësia të kalojë nga ta tek ish-bashkëshorti im, shtetasi L.Gj. Të ardhurat për blerjen e kësaj pasurie janë krijuar nga ish-vjehri im, shtetasi V.Gj, mbi bazën e fitimeve të realizuara nga shoqëria e tij “\*\*\*” sh.p.k., me NIPT J\*\*\*E, me objekt veprimtarie import-eksport. Rezulton sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2010, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, se kjo shoqëri për periudhën deri në datën 31.9.2010 nuk ka asnjë detyrim tatimor në tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, akcizat, kontribute të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat personale apo lloje të tjera detyrimesh.

Fakti që likuidimi është kryer që në vitet 1996 – 1997 provohet edhe nga kontrata noteriale e qirasë së tokës, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.10.1996... ”.

**65.** Pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni konstaton se ajo ka depozituar kontratën e qirasë së tokës nr. \*\*\*, datë 3.10.1996, ndërmjet palës qiradhënëse I.M dhe asaj qiramarrëse V.Gj dhe R.Gj, sipas së cilës përcaktohet se palët deklarojnë se qiramarrësit e kanë likuiduar vlerën 1,060,000 lekë, duke pranuar se qiramarrësit diferencën e papaguar prej 800,000 lekësh do ta likuidojnë nga 100,000 lekë çdo muaj. Në paragrafin e fundit të kësaj kontrate specifikohet se: “Këtë kontratë qiraje palët e konsiderojnë edhe si kontratë shitjeje, me detyrimin që, sapo të fillojë zbatimi i ligjit të shitblerjes së tokës bujqësore për këtë zonë, të përpilojnë aktin noterial të shitjes pa asnjë pagesë tjetër, sepse vleftha e sipërme si qira 30-vjeçare është në fakt vleftha e plotë e shitjes së kësaj sipërfaqeje”.

**65.1** Për sa më sipër, rezulton e provuar se tokat bujqësore janë blerë nga babai i ish-bashkëshortit të subjektit që në vitin 1996, por për shkak të ndalesave ligjore nuk është formalizuar kontrata e shitblerjes. Komisioni konstaton se kjo kontratë përputhet edhe me shpjegimet e subjektit gjatë hetimit, ku babai i ish-bashkëshortit deklaroi se i ka blerë tokat bujqësore për çmimin 300 lekë/m<sup>2</sup>. Komisioni, në kushtet kur subjekti provoi krijimin e kësaj pasurie në një kohë që ajo nuk ka qenë subjekt rivlerësimi, por as e lidhur me bashkëshortin e saj, vlerëson se nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për mungesë burimesh të ligjshme.

**66.** Komisioni vlerëson të ndalet në faktin se edhe në rastin që ish-bashkëshorti i subjektit do të rezultonte me mungesë burimesh të ligjshme, në kushtet kur:

- a. pasuritë e mësipërme rezulton e provuar se janë përdorur ekskluzivisht nga ish-bashkëshorti i subjektit vetëm për qëllim të ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij;
  - b. këto pasuri kanë kaluar të pronësi të një personi të tretë, pa u marrë miratimi i subjektit të rivlerësimit dhe nuk janë më në pronësi as të ish-bashkëshortit të saj;
  - c. këto pasuri rezulton e provuar se nuk janë përdorur asnjëherë nga subjekti, si dhe nga ana e saj pas zgjidhjes së martesës nuk është pretenduar bashkëpronësi,
- Bazuar në parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk mund të ngarkonte me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, pasi nuk përputhet me logjikën e mirë që të merret masa e shkarkimit për një pasuri që nuk ka qenë dhe nuk është e saj.

**67. Automjet tip “Mercedes-Benz”<sup>29</sup>** me targë AA \*\*\* GX, aktualisht në pronësi të subjektit, shkëmbyer me mjetin tip “Renault Fluence” me targë AA \*\*\* AE, blerë nëpërmjet faturës tatimore të shitjes nr. \*\*\*, datë 30.3.2011.

**Burimi sipas deklaratës Vetting:** Hua e dhënë nga Alpha Bank nëpërmjet kontratës nr. \*\*\*, datë 8.4.2011. Vlera: 15,000 euro.

### **Konstatimi i ILDKPKI-së**

- *Është i paqartë deklarimi lidhur me mënyrën e përfitimit të automjetit tip “Mercedes-Benz” nga L.Gj, me anë të shkëmbimit të automjetit tip “Renault Fluence”, pasi sipas konfirmimit të DPSHTRR-së këto automjete rezultojnë të jenë të dyja të blera prej tij dhe njëkohësisht në pronësi të tij deri në datën 27.1.2017. Rrjedhimisht, rezulton mosdeklarim i automjetit tip “Renault Fluence”, me vlerë 15,000 euro, në deklaratën Vetting dhe deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2015.*

### **Hetimi<sup>30</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**68.** DPSHTRR-ja ka konfirmuar në pronësi të shtetasit L.Gj automjetin me targë AA \*\*\* AE, ndërsa konfirmon se automjetin me targë AA \*\*\* UX (AA \*\*\* GX) e ka pasur në pronësi deri në datën 3.4.2017.

**69.** Në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë AA \*\*\* GX, rezulton se është blerë nga ish-bashkëshorti i subjektit në datën 13.6.2013, për shumën 2,000 euro dhe janë paguar detyrime doganore në shumën 60,753 lekë. Në lidhje me këtë automjet, ish-bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se e ka shkëmbyer me automjetin tip “Renault”, deklarim i cili nuk përputhet me dokumentacionin e administruar.

**70.** Në përgjigje të pyetësorit të datës 4.4.2024, subjekti ka sqaruar se: *“Pasi kam komunikuar me ish-bashkëshortin tim, shtetasin L.Gj, më ka bërë me dije se mjetin “Renault Fluence” e ka ndërruar me mjetin “Mercedes-Benz” me targë AA \*\*\* GX. Konkretisht, mjetin “Renault Fluence” me targë AA \*\*\* AE, në vitin 2014, ia ka dhënë shtetasit kosovar të quajtur H. Ish-bashkëshorti më ka dhënë numrin e telefonit të shtetasit H.*

*Në kuadër të bashkëpunimit me procesin kam komunikuar nëpërmjet telefonit me këtë shtetas kosovar, për faktin e sipërpërmendur. Ky i fundit, në kushtet kur banon në Kosovë, nuk kishte mundësi të vinte dhe më ka dërguar email. Konkretisht, në email-in e datës 16.4.2024 ka sqaruar se quhet H.H, me numër personal \*\*\* dhe me numër ID\*\*\*, duke deklaruar me vetëpërgjegjësi se në vitin 2014 ka këmbyer mjetin e tij “Mercedes-Benz” me targë AA \*\*\* GX me mjetin “Renault Fluence” me targë AA \*\*\* AE, ku mjete në atë kohë ka qenë me targa gjermane dhe ia kishte sjellë djali i xhaxhait nga Berlina, Gjermani. Nga komunikimi me ish-bashkëshortin më ka sqaruar se në mënyrë që të regjistronte mjetin “Mercedes-Benz” ka kryer zhdoganimin e mjetit dhe ka lidhur kontratë shitblerjeje për mjetin me shtetasen V.H, por nuk ka pasur shkëmbim lekësh”.*

<sup>29</sup> Bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë e pronësisë së automjetit tip “Daimler 211”, me targë E \*\*\* CD; (ii) faturë tatimore shitjeje nr. \*\*, datë 30.3.2011; (iii) leja e qarkullimi të automjetit tip “Renault” me targë AA \*\*\* AE; (iv) kontratë sigurimi e mjetit motorik dhe polica e sigurimit të automjetit tip “Renault” pranë E, gjatë periudhës 31.3.2011 – 30.3.2012; (v) vërtetim nga Alpha Bank, datë 23.1.2017.

<sup>30</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Alpha Bank nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021; kthim përgjigjeje datë 16.5.2024 e noterit publik J.B.

**71.** Në lidhje me këto sqarime të subjektit, ato mbeten në nivel deklarativ, si dhe deklarohen për herë të parë me këtë pyetësor. Ish-bashkëshorti i subjektit nuk rezulton ta ketë sqaruar këtë situatë në deklaratën *Vetting*, për më tepër ai nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për çregjistrimin e automjetit tip “Renault”, i cili rezulton edhe aktualisht në pronësi të tij. Ish-bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për të bërë kontratën e shkëmbimit të automjeteve. Ky konkluzion përforcohet edhe nga fakti se:

a. Nga të dhënat e AMF-së rezulton se janë prerë polica sigurimi për automjetin tip “Renault” nga ish-bashkëshorti i subjektit, për periudhën 23.4.2016 – 22.4.2017.

b. Nga hetimi i Komisionit është administruar kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 7.8.2014 (1 vit më vonë se blerja e automjetit tip “Mercedes-Benz”), sipas së cilës ish-bashkëshorti i subjektit ka shitur automjetin tip “Renault” tek shtetasi B.M për shumën 6,500 euro. Kjo kontratë nuk rezulton e regjistruar në DPSHTRR.

Në këto kushte, Komisioni do të konsiderojë si dokument për fitimin e pronësisë së automjetit kontratën e shitblerjes.

**72.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>31</sup> për krijimin e kësaj pasurie, nga e cila duket se ish-bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e saj, në shumën 513,092.38 lekë.

**73.** Në lidhje me automjetin tip “Renault Fluence”, rezulton se është blerë me faturë tatimore shitjeje nr. \*\*, datë 30.3.2011, me palë shitëse “P” sh.p.k. dhe blerës ish-bashkëshorti, kundrejt vlerës 15,000 euro.

**73.1** Ish-bashkëshorti i subjektit, me kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 13.4.2011, ka marrë hua shumën 9,500 euro, me afat shlyerjeje 7 vjet. Për të garantuar kredinë është lidhur kontratë për vendosjen e barrës siguroese nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.4.2011, ku parashikohet se sipas kontratës së huas nr. \*\*\*, datë 8.4.2011, huamarrësi pranon të vendosë në favor të bankës barrë siguroese mbi automjetin tip “Renault”.

**74.** Nga nxjerrja e llogarisë bankare të ish-bashkëshortit të subjektit në Alpha Bank rezulton se:

- Në datën 30.3.2011 depoziton *cash* shumën 5,500 euro dhe po në këtë datë e transferon në llogari të shoqërisë “P” sh.p.k., nën komentin “L.Gj për “P” sh.p.k., pagesë për makinë të re Reno sipas kontratës”.
- Në datën 15.4.2011 është disbursuar kredia në shumën 9,500 euro, e cila në po të njëjtën datë transferohet në llogari të shoqërisë “P” sh.p.k., nën komentin “L.Gj për “P” sh.p.k. lik. ft.\*\* ,datë 30.3.2011, për blerje automjeti “Renault Fluence”, shasi RF1\*\*\*”.

**75.** Komisioni ka kryer analizën financiare<sup>32</sup> lidhur me mundësinë e ish-bashkëshortit L.Gj për pagesën e kryer ndaj shoqërisë “P” sh.p.k. prej 5,500 euro, në datën 30.3.2011. Nga analiza financiare duket se ish-bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për pagesën prej 5,500 euro të kështit të parë të pasurisë automjet tip “Renault Fluence”, në vlerën 373,843.84 lekë.

**76.** Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi duket se ish-bashkëshorti:

<sup>31</sup> Shihni tabelën nr. 4 të rezultateve të hetimit.

<sup>32</sup> Shihni tabelën nr. 5 të rezultateve të hetimit.

- i. nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kontratën e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”;
- ii. nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shitjen e automjetit tip “Renault”;
- iii. ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, duke deklaruar se automjeti tip “Mercedes-Benz” është shkëmbyer me automjetin tip “Renault”;
- iv. nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjeti tip “Mercedes-Benz”;
- v. nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e këstit të parë të automjetit tip “Renault”, në shumën 5,500 euro;
- vi. nuk ka deklaruar se ka ende në pronësi automjetin tip “Renault”.

**77.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>33</sup> se: “Mjeti “*Renault Fluence*” me targë AA \*\*\* AE, vit prodhimi 2010, në vlerën 5,500 euro, është blerë personalisht nga ish-bashkëshorti L.Gj në datën 30.3.2011... pagesë për makine të re Reno sipas kontratës, është bërë në datën 30.3.2011, pra rreth 8 muaj para se unë të emërohesha si prokurore në stazh (viti i tretë i studimeve pranë Shkollës së Magjistraturës).

Gjithashtu, rezulton se edhe kredia për mjetin i është disbursuar në datën 15.4.2011, në shumën 9,500 euro... pra 7 muaj përpara se unë të filloja detyrën dhe jetesën me të.

Sa më sipër, në kushtet kur mjeti “*Renault Fluence*” me targë AA \*\*\* AE është pasuri personale e tij e blerë me të ardhurat e tij para se unë të filloja detyrën si prokurore, si dhe në kushtet kur nuk kam asnjë kontribut financiar në pagesën e çmimit të këtij automjeti, vlerësoj se krijimi i kësaj pasurie nga z. L.Gj nuk mund të ketë pasoja në procesin tim të rivlerësimit. Megjithatë, në frymën e bashkëpunimit dhe transparencës me Komisionin, nga ana ime janë marrë të gjitha masat për të provuar situatën faktike, duke kërkuar informacion nga ish-bashkëshorti i cili më ka sqaruar se për të kryer pagesën e këstit të parë të mjetit e ka ndihmuar me të ardhura familja e tij. Në kushtet kur ata nuk kanë pasur mundësi më shumë se vlera 5,500 euro, nga ana e tij është marrë kredi për pagesën e pjesën së mbetur nga në vlerën 9,500 euro.

Me mjetin “*Renault Fluence*” me targë AA \*\*\* AE, ish-bashkëshorti L.Gj ka pësuar një aksident, duke e dëmtuar rëndë, për këtë shkak nuk donte ta përdorte më atë. Prandaj këtë mjet *de facto* e ka shkëmbyer rreth vitit 2012 me shtetasin nga Kosova H.H (pa dokumentacion), ndërkohë nga ky i fundit ka marrë mjetin “*Mercedes-Benz*” me targë AA \*\*\* GX. Ky fakt provohet nga deklarimi nëpërmjet email-it të shtetasit H.H, si dhe nga të dhënat e pasqyruara në sistemin TIMS (bashkëlidhur këtij prapësimi) të shtetasit H.H, nga i cili rezulton se në vitet 2012 dhe 2013 ai ka pasur në posedim dhe ka udhëtuar me mjetin me targë AA \*\*\* AE.

Me ndërmjetësimin e shtetasit H.H është realizuar transportimi i mjetit dhe është realizuar formalisht kontrata e shitblerjes me palë shitëse shtetasen V.H dhe palë blerëse ish-bashkëshortin, për mjetin “*Mercedes-Benz*”, në vlerën 2,000 euro. Kjo kontratë është realizuar formalisht në Berlin, Gjermani, në datën 13.6.2013, për efekt zhdoganimi dhe regjistrimi të mjetit në emër të ish-bashkëshortit...

Ndërkohë, në kushtet kur mjeti “*Renault Fluence*” me targë AA \*\*\* AE ishte vetëm *de jure* në pronësi të ish-bashkëshortit, por jo *de facto*, me qëllim kalimin e pronësisë është realizuar

<sup>33</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

formalisht kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 7.8.2014, ndërmjet ish-bashkëshortit L.Gj dhe shtetasit nga Kosova B.M, për shumën 6,500 euro, me qëllimin e vetëm që të kalonte pronësia tek ky i fundit, por realisht pa shkëmbim lekësh... Nga këqyrja e sistemit TIMS provohet fakti se mjeti “Renault Fluence” me targë AA \*\*\* AE ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 7.8.2014, ora 08:58:00 drejtuar nga shtetasi Xh.M. Po në këtë datë është bërë kontrata e shitjes së mjetit nr. \*\*\*, datë 7.8.2014, ndërmjet ish-bashkëshortit L.Gj dhe shtetasit B.M, më pas, në orën 19:06:56 po të së njëjtës datë 7.8.2014, shtetasi B.M ka udhëtuar me mjetin me targë AA \*\*\* AE në dalje të Republikës së Shqipërisë nga pika kufitare Morinë, rreth orës 19:06:56. Rezulton se shtetasi B.M ka prishur marrëveshjen për blerjen e mjetit, duke ia kthyer mjetin personit me të cilin kishte komunikuar për t’ia blerë... Sa më sipër, provohet edhe me faktin që në momentin që i lindi detyrimi ligjor për deklarim si pasojë e martesës me mua, ai ka deklaruar në deklarinimin vjetor periodik për vitin 2015 gjendjen faktike që kishte, pra vetëm autoveturën “Mercedes-Benz” me targë AA \*\*\* GX, në vlerën 13,000 euro. Kjo vlerë është deklaruar nga ana e tij pasi ndërkohë shlyente detyrimet e kredisë së marrë për mjetin “Renault”, të cilin nuk e kishte faktikisht, por vetëm de jure. Nuk bën sens logjik dhe as ekonomik që ai të deklaronte një vlerë shumë herë më të lartë të mjetit Benz se sa realisht ishte pasqyruar në kontratën e shitjes së këtij mjeti. Ky deklarim vlere mjeti provon se shkëmbimi i mjeteve ka qenë real, shtuar këtu edhe faktin që kjo situatë është pasqyruar edhe në deklaratën Vetting, duke sqaruar më të detajuar se mjetin “Mercedes-Benz” e ka shkëmbyer me mjetin “Renault”, ku ka treguar qasje korrekte dhe të sinqertë në raport me deklarinimin e tij në deklaratat e interesave privatë ndër vite. Pra, në vitin 2013, nga ana e bashkëshortit është paguar vetëm vlera e zhdoganimit të automjetit “Mercedes-Benz”. Më poshtë paraqitet analiza financiare për kryerjen e shpenzimeve të zhdoganimit, e cila rezulton me një diferencë negative në shumën -232,672 lekë. Dua të sqaroj se gjatë vitit 2013 rezulton se ish-bashkëshorti L.Gj ka pasur udhëtime të shumta jashtë vendit për shkak të marrëdhënieve të tij të punës (ku ai ka udhëtuar i vetëm, jo së bashku me mua), shpenzime të cilat të gjitha janë përballuar tërësisht nga ana e tij. Ai më ka deklaruar se një pjesë e tyre janë mbuluar nga familja e tij dhe një pjesë nga shoqëritë tregtare me të cilat bashkëpunonte apo kryente aktivitetet. Nuk kam kontribuar asnjëherë në asnjë lloj forme për përballimin e shpenzimeve të tij personale.

Sikurse rezulton edhe nga këqyrja e sistemit TIMS, ish-bashkëshorti im, shtetasi L.Gj, edhe para njohjes me mua, edhe gjatë kohës që kemi qenë bashkë, por edhe pas ndarjes, ka të njëjtën rutinë të lëvizjes jashtë shtetit, fakt ky që tregon se unë asnjëherë nuk kam kontribuar financiarisht për shpenzimet e udhëtimeve të tij...”.

**78.** Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato duhet të merren pjesërisht në konsideratë. Është e vërtetë sikundër pretendon subjekti se pasuria automjet tip “Renault” është krijuar përpara marrjes së detyrës së subjektit, por Komisioni i ka kaluar barrën e provës për vetë faktin se kemi të bëjmë me një pasuri që shërben (pretendimi i subjektit se është shkëmbyer) si burim për një pasuri të deklaruar në deklaratën Vetting. Subjekti pas kalimit të barrës së provës pretendoi si burim edhe të ardhurat e prindërve të ish-bashkëshortit të saj për këtë automjet. Në kushtet kur automjeti tip “Renault” nuk është pjesë e deklaratës Vetting, si dhe duke marrë në konsideratë të ardhurat e konsiderueshme të prindërve të ish-bashkëshortit të subjektit, të ardhura për të cilat nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore, por që në rastin në fjalë nuk mund të përbëjnë pengesë për një pasuri, e cila është krijuar para detyrës dhe martesës së subjektit, Komisioni vlerëson se ish-bashkëshorti i subjektit justifikon me të ardhura blerjen e kësaj pasurie. Në lidhje me shkëmbimin e këtij automjeti me automjetin tip



“Mercedes-Benz”, ky shkëmbim, pavarësisht provave të depozituara nga subjekti, nuk u arrit të provohej plotësisht, pasi nga ana e ish-bashkëshortit nuk është lidhur asnjë kontratë shkëmbimi për automjetin tip “Renault”. Ish-bashkëshorti i subjektit duhet të kryente të gjitha procedurat e nevojshme, si dhe duhej të tregonte kujdesin e duhur, duke marrë në konsideratë se kishte një lidhje me një subjekt deklarues. Nga ana e DPSHTRR-së rezultoi e provuar që ky automjet është ende në pronësi të ish-bashkëshortit të subjektit, për rrjedhojë ajo duhej të tregonte kujdesin e duhur duke verifikuar deklarinë e ish-bashkëshortit me të dhënat e DPSHTRR-së.

**78.1** Për rrjedhojë, rezultoi se deklarimi i ish-bashkëshortit të subjektit nuk është i saktë, por kjo pasaktësi, për sa kohë nuk shoqërohet me mungesë burimesh të ligjshme, si dhe deklarimi i vlerës së saj ka qenë i saktë, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

**79.** Në lidhje me vlerën negative të blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, Komisioni vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme në shumën 513,092.38 lekë, duke marrë në konsideratë edhe faktin se udhëtimet e ish-bashkëshortit të subjektit mund të jenë të mbuluara nga të ardhurat e shoqërisë, si dhe kjo blerje është bërë në një periudhë që subjekti nuk ka qenë e martuar me të, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit.

**79.1** Komisioni, në vlerësimin e tij në lidhje me këtë automjet, mban në vëmendje se këto veprime janë kryer nga ish-bashkëshorti i subjektit dhe deklarinë e tij lidhen me një automjet i cili aktualisht nuk është më në pronësi të tij, si dhe të ardhurat e këtij automjeti nuk janë pretenduar dhe nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, kjo pasuri është një pasuri vetjake e ish-bashkëshortit të subjektit, pasi është krijuar në një periudhë ku nuk ka qenë i martuar.

**80. Administrator i shoqërisë “G” sh.p.k.**<sup>34</sup> dhe aksioner në pjesën 100% të kapitalit, me NIPT K\*\*\*F. Pjesa takuese: 100%.

**81. Aksioner në 51% në shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.**<sup>35</sup> me qendër në P, Durrës, me NIPT L\*\*\*R.

**82. Ortak i shoqërisë “G.G”**<sup>36</sup> dhe aksioner në pjesën 33% të kapitalit, me NIPT L\*\*\*B.

**83. Administrator i shoqërisë “G.C” sh.p.k.**<sup>37</sup> dhe aksioner në pjesën 20% të kapitalit, me NIPT L\*\*\*T.

**84. Administrator i shoqërisë “L&D P” sh.p.k.**<sup>38</sup> dhe aksioner në pjesën 100% të kapitalit, me NIPT L\*\*\*B.

---

<sup>34</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “G” sh.p.k.; (ii) pasqyrë financiare e shoqërisë “G” sh.p.k. për vitin 2015; (iii) shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, e DRT Durrës.

<sup>35</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “\*\*\*” sh.p.k.; (ii) pasqyrë financiare e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. për vitin 2015; (iii) shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, e DRT Durrës.

<sup>36</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “G.G” sh.p.k.; (ii) pasqyrë financiare e shoqërisë “G.G” sh.p.k. për vitin 2015; (iii) shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, e DRT Durrës.

<sup>37</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “G.C” sh.p.k.; (ii) pasqyrë financiare e subjektit tregtar “G.C” sh.p.k. për vitin 2015; (iii) kthim përgjigjeje e DRT Durrës nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017.

<sup>38</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “L&D P” sh.p.k.

**85. Administrator i shoqërisë “A” sh.p.k.**<sup>39</sup> dhe aksioner në pjesën 50% të kapitalit, me NIPT L\*\*\*A.

#### **Hetimi<sup>40</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**86.** Në lidhje me shoqëritë G sh.p.k., “\*\*\*” sh.p.k., “G.C” sh.p.k., “L&D P” sh.p.k. dhe “A” sh.p.k., rezulton se QKB-ja konfirmon deklarinimin e ish-bashkëshortit të subjektit, ndërkohë DRT-ja ka informuar se pavarësisht se këto shoqëri kanë pasur fitim, nuk është shpërndarë dividend.

**87.** Komisioni, nga ekstrakti historik i shoqërisë “G.G” sh.p.k. ka konstatuar se:

- a. deri në datën 27.1.2017 ish-bashkëshorti i subjektit zotëron 33% të vlerës së kapitalit sipas vendimit të asamblesë datë 23.12.2015, nëpërmjet të cilit është bërë zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë nga 200,000 euro në 150,000 euro;
- b. në datën 12.4.2017 është riemëruar administrator i shoqërisë dhe në datën 12.6.2017 ka transferuar në emër të tij 100% të kuotave. Statusi i aktivitetit “aktiv”;
- c. bazuar në aktin e themelimit të shoqërisë, kontributi i ish-bashkëshortit të subjektit ka qenë në vlerën 50,000 euro në kapitalin themeltar.

**88.** Në lidhje me këtë shoqëri, nga hetimi ka rezultuar se në datën 16.2.2017 ish-bashkëshorti i subjektit ka blerë kuotat e ortakëve të tjerë, si vijon:

- kuotën e shtetasit R.Xh në shumën 50,000 euro;
- kuotën e shtetasit J-G.E.L.R në vlerën 37,500 euro, si dhe kthimin e huas dhënë shoqërisë në vlerën 62,500 euro;
- kuotën e shtetasit Z.K në vlerën 12,500 euro, si dhe kthimin e huas dhënë shoqërisë në vlerën 22,500 euro.

**89.** Në lidhje me këto shuma, duket se ato nuk janë paguar nga ish-bashkëshorti i subjektit, pasi nga hetimi ka rezultuar se ai ka lidhur kontratat e mëposhtme<sup>41</sup>:

- i. kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 26.4.2017, për pasurinë nr. \*\*\*, lidhur midis ish-bashkëshortit të subjektit dhe shtetasve Z.K e J-G.E.L.R për garantimin e huas në shumën 100,000 euro të z. R dhe në shumën 35,000 euro të z. K;
- ii. kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 13.4.2017, për pasurinë nr. \*\*\*, për garantimin e së njëjës hua;
- iii. deklaratë për njohje detyrim shume nr. \*\*\*, datë 15.3.2017, nëpërmjet së cilës ish-bashkëshorti i subjektit i njeh detyrimin në shumën 100,000 euro z. R;
- iv. deklaratë për njohje detyrim shume nr. \*\*\*, datë 15.3.2017, nëpërmjet së cilës i njeh detyrimin në shumën 290,000 euro z. R.Xh;
- v. deklaratë për njohje detyrim shume nr. \*\*\*, datë 15.3.2017, nëpërmjet së cilës i njeh detyrimin në shumën 35,000 euro z. K.

<sup>39</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “A” sh.p.k.; (ii) kthim përgjigjeje e DRT Durrës nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017.

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021, drejtuar DPT-së; kthim përgjigjeje e DRT Durrës nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021, drejtuar QKB-së; kthim përgjigjeje e QKB-së nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021.

<sup>41</sup> Shkresë kthim përgjigjeje datë 9.5.2024, noteri publik R R.

**90.** Komisioni ka kryer një analizë<sup>42</sup> për mundësinë e ish-bashkëshortit të subjektit për kontributin e tij në kapitalin themeltar në shumën 50,000 euro. Nga analiza financiare duket se ish-bashkëshorti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kontributin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë “G.G”.

**91.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>43</sup> se: *“...Për t’i dhënë përgjigje barrës së provës të kaluar nga Komisioni, i kam kërkuar ish-bashkëshortit që të më shpjegonte rreth konstatimit, si dhe të më vinte në dispozicion dokumentacionin përkatës. Pas shumë përpjekjesh, në kushtet kur komunikimi jonë është ndërprerë prej rreth 8 vitesh dhe është minimal vetëm për çështje që lidhen me djalin tonë, në datën 17.7.2024 ish-bashkëshorti (i cili aktualisht ka krijuar një jetë të re dhe jeton jashtë Shqipërisë) ka ardhur në Shqipëri për të administruar dokumentacionin dhe për të sqaruar barrën e provës... Në deklaratën noteriale të datës 17.7.2024 ai ka sqaruar se nuk e ka kryer pagesën për kontributin themeltar të shoqërisë “G.G” sh.p.k. Ai ka deklaruar se shoqëria ka operuar vetëm me dy banka, dhe konkretisht Bankën Kombëtare Tregtare dhe Societe Generale Bank (aktualisht OTP Bank) dhe nga ana e tij më janë vendosur në dispozicion statement-et e dy bankave të mësipërme. Nga verifikimi i statement-eve të bankave si më sipër rezulton se nga ish-bashkëshorti nuk është kryer asnjë pagesë për shlyerjen e kapitalit themeltar... Në këto statemente nuk rezulton që ish-bashkëshorti të ketë kryer pagesë për shlyerjen e kapitalit themeltar, por rezultojnë vetëm derdhje në shuma të vogla në cilësinë e administratorit, për të cilat ish-bashkëshorti deklaroi se kanë qenë me qëllim të aktivitetit operacional të shoqërisë. Ai deklaroi se si pasojë e mosfunksionimit të shoqërisë ka pasur edhe mosmarrëveshje me ortakët, të cilëve ju ka njohur detyrimet përkatëse... Të dhënat që burojnë nga provat e administruara gjatë hetimit, statement-et e plota të dy bankave me të cilat ka operuar shoqëria “G.G” sh.p.k., bazuar edhe në deklaratimet e ish-bashkëshortit, shtetasit L.Gj dhe shtetasit R.Xh, rezulton se ish-bashkëshorti nuk e ka paguar vlerën e 33% të kuotave. Në kushtet kur ish-bashkëshorti nuk i ka shlyer kuotat e kapitalit në këtë shoqëri, vlerësoj se kjo vlerë nuk mund të përfshihet në analizën financiare të vitit 2015. Nga ana tjetër, dua të theksoj se kjo shoqëri është krijuar përpara martesë, personalisht prej tij dhe unë nuk kam kontribuar, nuk kam përfituar asnjë interes nga kjo shoqëri, as gjatë martesës dhe as pas zgjidhjes së saj”.*

**92.** Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni konstaton se me të drejtë ajo pretendon se nga ish-bashkëshorti i saj nuk është paguar kapitali themeltar në shumën 50,000 euro, pasi nuk ka asnjë derdhje të tillë në llogaritë bankare të shoqërisë “G.G” sh.p.k. Ndërkohë, nga provat e depozituara nga subjekti vërtetohet se nga verifikimi i nxjerrjes së llogarisë së shoqërisë “G.G” sh.p.k. në BKT dhe OTP Bank ka depozitime nga dy ortakët e tjerë të shoqërisë, konkretisht:

- në datën 27.5.2015, ortaku R.Xh ka transferuar kuotat e kapitalit në vlerën 50,000 euro nga llogaria e tij personale në llogarinë e shoqërisë “G.G” sh.p.k., me nr. AL\*\*F, në BKT;
- në datën 24.4.2025, ortaku J-G.E.L.R ka shlyer vlerën e tij të kapitalit fillestar në llogarinë e shoqërisë në OTP Bank, me nr. AL\*\*\*, në vlerën 50,000 euro, nën komentin *“J.R foreign investment of M. J.R 25 of shares of capital of new company G.G sh.p.k. Tirana”*.

<sup>42</sup> Shihni tabelë nr. 6 të rezultateve të hetimit.

<sup>43</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

**92.1** Për sa më sipër, bazuar edhe në veprimet e tjera të ish-bashkëshortit të subjektit në lidhje me këtë shoqëri, vlerësohet se nga ana e tij nuk rezulton të jetë likuiduar realisht kapitali themeltar, duke mos u përmbushur detyrimi ligjor i parashikuar nga legjislacioni tatimor.

**93.** Në lidhje me këtë konstatim, për sa kohë subjekti nuk rezulton të jetë përfituese apo të ketë kontribuar në krijimin e kësaj shoqërie, si dhe ortak i vetëm i saj është ish-bashkëshorti, Komisioni çmon se nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për mospërmbushjen e detyrimeve të legjislacionit tregtar dhe tatimor nga ana e ish-bashkëshortit të subjektit.

**94. Nxjerrje të dhënash për llogaritë rrjedhëse<sup>44</sup> në lekë**, me nr. \*\*\*, me shumë disponibël 904.28 lekë; në euro, me nr. \*\*\*, me shumë disponibël 3.96 euro; në USD, me nr. \*\*\*, me shumë disponibël 17.88 USD; në CHF, me nr. \*\*\*, me shumë disponibël 27.26 CHF. Të gjitha llogaritë rrjedhëse janë pranë Societe Generale Albania Bank në emër të shtetasit L.Gj.

#### **Hetimi<sup>45</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**95.** Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë OTP Bank rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit, z. L.Gj, është mbajtës i:

i) Llogarisë rrjedhëse nr. \*\*\* në monedhën lek, hapur në datën 10.6.2015, e cila në datën 27.1.2017 rezulton me gjendje 1,904.28 lekë;

Nga nxjerrja e llogarisë rezulton se:

- në datën 1.12.2015, shtetasi E.A ka depozituar shumën 500,000 lekë, e cila është tërhequr *cash* në të njëjtën datë;
- kjo shumë nuk është përfshirë në analizën financiare, nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting*, nuk është depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit E.A, si dhe nuk janë paguar detyrimet tatimore.

ii) Llogarisë rrjedhëse nr. \*\*\* në monedhën euro, hapur në datën 22.4.2015, e cila në datën 27.1.2017 rezulton me gjendjen 3.96 euro;

iii) Llogarisë rrjedhëse nr. \*\*\* në monedhën USD, hapur në datën 30.4.2015, e cila në datën 27.1.2017 rezulton me gjendjen 17.88 USD;

iv) Llogarisë rrjedhëse nr. \*\*\* në monedhën CHF, hapur në datën 22.4.2015, e cila në datën 27.1.2017 rezulton me gjendjen 27.26 CHF.

**Në përfundim** nuk ka paqartësi dhe deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

**96. Nxjerrje të dhënash për llogaritë rrjedhëse në lek**, nr. AL\*\*\*, pranë Alpha Bank, në emër të shtetasit L.Gj, në vlerën 0 (zero) lekë.

**97. Nxjerrje të dhënash për llogaritë rrjedhëse<sup>46</sup> në euro**, nr. AL\*\*\*, pranë Alpha Bank, në emër të shtetasit L.Gj, në vlerën 0 (zero) euro.

<sup>44</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmimin bankar nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, nga Societe Generale Albania.

<sup>45</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e OTP Bank nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2021.

<sup>46</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë në emër të shtetasit L.Gj, pranë Alpha Bank, gjatë periudhës 1.4.2011 – 30.4.2011 dhe datës 31.12.2016. Gjendja në llogari 0 (zero) euro.

## **Hetimi<sup>47</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**98.** Nga nxjerrjet e llogarive bankare në Alpha Bank rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit L. Gj është:

- a. Mbjtës i llogarisë rrjedhëse në monedhën lek, nr. AL\*\*\*. Kjo llogari është hapur në datën 29.9.2009, e cila ka shërbyer si llogari page deri më 4.12.2012. Në datën 27.1.2017 rezulton me gjendje 0 (zero) lekë.
- b. Është mbajtës i llogarisë rrjedhëse në monedhën euro, nr. AL\*\*\*, hapur në datën 30.3.2011 dhe përdorur deri më 19.12.2016. Në datën 27.1.2017 rezulton me gjendje 0 (zero) euro.
  - Në datën 20.5.2011, shtetasi P.P ka transferuar shumën 25,000 euro;
  - Në datën 8.7.2011, shtetasi P.P ka transferuar shumën 35,000 euro;
  - Në datën 19.12.2016, shtetasi P.P ka transferuar shumën 2,000 euro, me emërtimin “Për shpenzimet e vilës”.

Këto shuma nuk janë përfshirë në analizën financiare, pasi nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, nuk është depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të shtetasit P.P, si dhe nuk janë paguar detyrimet tatimore.

**99.** Në lidhje me këto vlera, subjekti sqaroi se ato janë dërguar nga ky shtetas për të ndërtuar objektin e ndodhur në tokën në pronësi të ish-bashkëshortit të subjektit në Sh, Durrës, trajtuar në pikën 37 e në vijim të këtij vendimi.

**100.** Nxjerrje të dhënash për llogaritë rrjedhëse<sup>48</sup> në euro, nr. \*\*\*, pranë Credins Bank, në emër të shtetasit L.Gj, në vlerën 31.8 euro.

**101.** Nxjerrje të dhënash për llogaritë rrjedhëse<sup>49</sup> në lekë, nr. \*\*\*, pranë Credins Bank, në emër të shtetasit L.Gj, në vlerën 293.00 lekë.

## **Hetimi<sup>50</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**102.** Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë Credins Bank rezulton se ish-bashkëshorti i subjektit, z. L.Gj, është mbajtës i:

i) Llogarisë rrjedhëse nr. \*\*\* në monedhën euro, hapur në datën 20.5.2016, e cila në datën 27.1.2017 rezulton me gjendje 293 euro.

Në datën 20.5.2016 rezulton të jetë transferuar shuma 3,500 euro nga shoqëria “G.C” sh.p.k., me përshkrimin “Dhënie huaje”. Kjo shumë është tërhequr *cash* nga ish-bashkëshorti i subjektit në të njëjtën datë.

Kjo hua nuk rezulton e deklaruar në deklaratën *Vetting*, si dhe nga ana e subjektit nuk rezulton të jetë deklaruar qëllimi i marrjes dhe përdorimit të saj. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e

<sup>47</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Alpha Bank nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021.

<sup>48</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë në emër të shtetasit L.Gj, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 4.3.2014 – 30.12.2016.

<sup>49</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë në emër të shtetasit L.Gj, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 4.3.2014 – 30.12.2016.

<sup>50</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.01.2021, drejtuar bankave; kthim përgjigjeje e Credins Bank nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2021.

administruara nga tatimet rezulton që kjo shoqëri ka dalë me humbje, duke mos pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas.

Për sa më sipër, subjektit iu kërkuan shpjegime, pasi:

- ish-bashkëshorti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* huan e marrë nga shoqëria “G.C” sh.p.k.;
- shoqëria “G.C” sh.p.k. nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas;
- subjekti nuk ka deklaruar qëllimin dhe marrjen e huas.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>51</sup> se: *“Në kushtet kur edhe personalisht nëpërmjet raportit mbi rezultatet e hetimit të datës 5.7.2024 jam vënë në dijeni të këtij veprimi, i kam kërkuar ish-bashkëshortit që të sqarojë këtë konstatim. Në deklaratën noteriale të datës 17.7.2024 ai ka deklaruar se shuma prej 3,500 euro, me sa kujton, ka qenë një paradhënie për pagën nga shoqëria “G.C” sh.p.k., duke sqaruar se ai ka deklaruar se është administrator i shoqërisë “G.C” sh.p.k., si dhe aksioner në pjesën 20% të kapitalit. Sikurse rezulton në deklaratën *Vetting*, ai ka deklaruar të ardhura nga kjo shoqëri, duke bashkëlidhur vërtetimin e të ardhurave. Sa më sipër shpjeguar, nuk kam pasur dijeni për këtë veprim të tij, por në kushtet kur analiza financiare e vitit 2016 është pozitive edhe pa përfshirë në këtë analizë shumën 3,500 euro, edhe sikur të konsiderojmë pasaktësinë në DPV-në vjetore apo në deklaratë nga ish-bashkëshorti, ky mosdeklarim mbetet i karakterit formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit”.*

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se për sa kohë nga ana e ish-bashkëshortit është sqaruar se kjo është një pagesë paradhënie e pagës, duke marrë në konsideratë edhe vlerën e vogël të saj, si dhe faktin që nuk është përdorur si burim për ndonjë pasuri të subjektit, vlerëson se shpjegimet e saj janë bindëse.

ii) Llogarisë rrjedhëse nr. \*\*\* në monedhën lek, hapur në datën 9.11.2012, e cila në datën 27.1.2017 rezulton me gjendje 293 lekë.

Nga nxjerrja e llogarisë rezulton se:

- a. në datën 4.3.2014 është transferuar shuma 2,793,280 lekë, e cila është tërhequr *cash* në po të njëjtën datë;
- b. në datën 15.5.2014 është depozituar shuma 624,950 lekë nga shtetasi E.V, e cila është tërhequr *cash* në po të njëjtën datë;
- c. në datën 18.6.2014 është transferuar shuma 1,740,000 lekë, e cila është tërhequr *cash* në po të njëjtën datë;
- d. në datën 22.1.2015 është depozituar shuma 500,000 lekë nga shtetasi E.A, e cila është tërhequr *cash* në po të njëjtën datë;
- e. në datën 27.1.2015 është depozituar shuma 200,000 lekë nga shtetasi A.H, e cila është tërhequr *cash* në po të njëjtën datë;
- f. në datën 3.2.2015 është depozituar shuma 150,000 lekë nga shtetasi A.H, e cila është tërhequr *cash* në po të njëjtën datë;
- g. në datën 13.2.2015 është transferuar shuma 98,280 lekë nga shtetasi B.B, me emërtimin “Kthim borxhi K.B”;

---

<sup>51</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

h. në datën 1.2.2016 është depozituar shuma 150,000 lekë nga shtetasi A.T, e cila është tërhequr *cash* në po të njëjtën datë.

Këto shuma nuk janë përfshirë në analizën financiare, pasi nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, nuk është depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave, si dhe nuk janë paguar detyrimet tatimore.

**103. Nxjerrje të dhënash për llogaritë rrjedhëse<sup>52</sup> në lek, nr. \*\*\*, pranë Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit L.Gj, në vlerën 00.00 lekë.**

**104. Nxjerrje të dhënash për llogaritë rrjedhëse<sup>53</sup> në lek, nr. \*\*\*, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në emër të shtetasit L.Gj, në vlerën 00.00 lekë.**

#### **Hetimi<sup>54</sup>/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**105.** Në lidhje me këto dy llogari bankare nuk janë konstatuar paqartësi apo transferta në vlera të konsiderueshme.

**106.** Komisioni gjatë hetimit ka konstatuar së në llogaritë bankare të ish-bashkëshortit të subjektit janë depozituar shuma të ndryshme, përveç atyre të listuara më lart. Duke qenë se këto shuma duket se janë transferuar për efekt të veprimtarisë së tij tregtare, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare. Subjekti në lidhje me këto shuma dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit nuk pretendoi që ato të ishin përdorur nga ana e saj gjatë martesës me ish-bashkëshortin.

#### **107. Në lidhje me të ardhurat nga qiraja<sup>55</sup>**

Bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar:

- i. të ardhura nga qiraja për ambientin ndërtesë industriale me palë qiradhënëse L.Gj dhe qiramarrës shoqëria “\*\*\*\*”, datë 22.9.2015, me vlerë qiraje 62,685 lekë;
- ii. të ardhura nga qiraja për ambientin ndërtesë industriale me palë qiradhënëse L.Gj dhe qiramarrës shoqëria “G.G” sh.p.k., sipas kontratës së qirasë datë 30.4.2015, me vlerë qiraje 660.00 euro/muaj.

**107.1** Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, përmes shkresës nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, në bazë të informacionit të marrë nga sistemi C@ts informon se:

- i. shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ka deklaruar shpenzime të kryera për kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2015, për periudhën tetor 2015 – dhjetor 2015, pagesë qiraje 188,055 lekë dhe pagesë tatimi i qirasë 28,209 lekë, për periudhën janar 2016 – dhjetor 2016, pagesë qiraje 752,220 lekë dhe pagesë tatimi i qirasë 112,833 lekë;

<sup>52</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë në emër të shtetasit L.Gj pranë Raiffeisen Bank, datë 27.1.2017.

<sup>53</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë në emër të shtetasit L.Gj pranë BKT-së, gjatë periudhës 1.1.2016 – 31.12.2016.

<sup>54</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e BKT-së nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021.

<sup>55</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2015; (ii) vërtetim nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; (iii) kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës; (iv) kontratë qiraje datë 30.4.2015; (v) vërtetim nga shoqëria “G.G” sh.p.k.; (vi) kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

ii. shoqëria “G.G” sh.p.k. ka deklaruar shpenzime të kryera për kontratë qiraje datë 30.4.2015, për periudhën janar 2016 – dhjetor 2016, pagesë qiraje 1,252,226 lekë dhe pagesë tatimi i qirasë 188,549 lekë.

**107.2** Për sa më sipër, nuk ka paqartësi dhe përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

**108.** Në datën 22.9.2016, me deklaratë noteriale nr. \*\*\*, ish-bashkëshorti<sup>56</sup> i subjektit deklaronte se i ka marrë hua shtetasit F.Q shumën 14,000 euro në datën 1.3.2016 dhe do ta kthejë këtë shumë brenda datës 21.10.2016.

**108.1** Komisioni ka kryer një analizë financiare<sup>57</sup> në lidhje me kthimin e shumës 14,000 euro për periudhën 2.3.2016 – 21.10.2016. Kjo analizë është kryer brenda kësaj periudhe, pasi nga ana e subjektit nuk rezulton që kjo hua të jetë deklaruar në deklaratën *Vetting*, por edhe në deklaratat periodike.

**108.2** Nga analiza financiare duket se subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e kësaj huaje në shumën 1,090,864.87 lekë, si dhe nuk rezulton që kjo hua të jetë deklaruar në deklaratën *Vetting*.

**109.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>58</sup> se: *“Bëj me dije se për ekzistencën e këtij veprimi juridik ndërmjet ish-bashkëshortit dhe shtetasit F.Q jam vënë në dijeni në datën 5.7.2024 nëpërmjet raportit mbi rezultatet e hetimit... Kjo marrëdhënie huaje, si dhe deklarata noteriale, asnjëherë nuk më është bërë me dije as nga ish-bashkëshorti... Në kushtet kur nuk kam pasur dijeni për këtë fakt i kam kërkuar ish-bashkëshortit që të sqarojë këtë konstatim dhe në deklaratën noteriale të datës 17.7.2024 ai ka deklaruar se huaja ndaj shtetasit F.Q ka qenë një hua e tij personale, të cilën e ka marrë për shkak të vështirësive ekonomike dhe personale dhe që ende nuk ia ka kthyer, pasi nuk ka pasur mundësi ekonomike.*

*Gjithashtu, ai më ka bërë me dije që këtë shume shtetasi F.Q e ka kërkuar edhe gjyqësisht dhe më ka vënë në dispozicion dy vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht:*

- *vendimin nr. \*\*\*, datë 21.2.2017, me palë paditëse F.Q dhe palë të paditur L.Gj, me objekt kthimi i shumës 14,000 (katërbëdhjetë mijë) euro së bashku me interesat e përcaktuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2016, për moskthimin e kësaj shumë brenda afatit të përcaktuar;*
- *vendimin nr. \*\*\*, datë 16.6.2017, me palë paditëse F.Q dhe palë të paditur L.Gj, me objekt kthimin e shumës 14,000 (katërbëdhjetë mijë) euro së bashku me interesat e përcaktuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2016.*

*Mosdeklarimi i kësaj huaje në deklaratën Vetting është një pasaktësi e ish-bashkëshortit tim, e cila në kushtet kur nuk shoqërohet me pamjaftueshmëri financiare, nuk përben shkak për marrjen e masës disiplinore”.*

**110.** Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni konstaton se bazuar në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ish-bashkëshorti i subjektit nuk i ka kthyer huan në kohë shtetasit F.Q. Në këto kushte, provohet që në vitin 2016 ish-bashkëshorti i subjektit rezulton të mos e ketë kthyer huan në shumën

<sup>56</sup> Shkresë kthim përgjigjeje datë 16.5.2024, e noterit publik J.B.

<sup>57</sup> Shihni tabelën nr. 7 të rezultateve të hetimit.

<sup>58</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.



14,000 euro, për rrjedhojë analiza financiare në lidhje me kthimin e kësaj huaje nuk ka ndikim në vlerësimin e pasurisë të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë ajo rezulton me burime të mjaftueshme të ligjshme në shumën 1,322,296 lekë nëse vlera 14,000 euro nuk përfshihet si shpenzim. Në lidhje me mosdeklarimin e kësaj huaje në deklaratën *Vetting*, kjo pasaktësi i përket ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, duke marrë në konsideratë se: (i) kjo hua nuk është përdorur si burim për ndonjë pasuri të subjektit; (ii) rezulton e provuar se detyrimin për të kthyer këtë hua e ka ish-bashkëshorti i subjektit bazuar në vendimet gjyqësore të cituar më lart; (iii) kjo hua nuk rezulton e kthyer gjatë kohës që subjekti ka qenë e martuar – vlerëson se pasaktësia e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk mund të sjellë pasoja në vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

**111.** Në përfundim të analizës financiare<sup>59</sup> prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë një pamundësi financiare në vlerën - 8,887,487.24 lekë.

**112.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>60</sup> se: *“Diferenca në analizën financiare të përgjithshme vjen kryesisht se në këtë analizë është përfshirë:*

- *pagesa e tokës bujqësore në vitin 2023, e cila nuk është kryer;*
- *pagesa për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, i cili është shkëmbyer me automjetin “Renault”;*
- *pagesa e 33% të kuotave në shoqërinë “G.G” sh.p.k., të cilat nuk janë likuiduar.*

*Nga të gjitha rrethanat e analizuar nga hetimi administrativ vlerësoj se nuk duhet të analizohem së bashku me ish-bashkëshortin deri në momentin e lidhjes së martesës ligjore, pasi jetesa jonë nuk ka pasur karakterin e një bashkëjetese të qëndrueshme dhe fikse të tillë që ne të përgjigjeshim solidarisht për shpenzimet e jetesës dhe kontributin solidarisht. Nuk kam kontribuar asnjëherë në asnjë lloj forme për përballimin e shpenzimeve të tij personale dhe ç’është më e rëndësishme nuk kam përfituar asnjë interes pasuror prej tij as gjatë martesës dhe as pas saj... Sikurse rezulton edhe nga sistemi TIMS, ai ka pasur lëvizje të konsiderueshme jashtë shtetit, ku ka udhëtuar vetëm pa mua për shkak të marrëdhënieve të tij të punës (para njohjes, gjatë njohjes dhe pas ndarjes me mua), të gjitha këto shpenzime janë përballuar nga ana e tij personalisht, ashtu sikurse edhe detyrimet për pagesën e këstit të kredisë të mjetit “Renault”, të blerë personalisht prej tij para se unë të filloja detyrën si prokurore. Nga hetimi konstatohet qartë që ish-bashkëshorti L.Gj të gjitha pasuritë që ka pasur kanë qenë pasuri vetjake të krijuara para lidhjes së martesës tonë, prandaj nuk janë bërë pjesë asnjëherë në bashkësi ligjore, asnjëherë nuk janë përdorur, poseduar, kërkuar apo pretenduar nga ana ime, për shkak se burim i krijimit të këtyre pasurive është puna e prindërve të tij. Nëse analiza financiare do të kryhet e ndarë deri në momentin e lidhjes së martesës, në analizën financiare nuk do të rezultonte asnjë balancë negative. Ish-bashkëshorti, shtetasi L.Gj, gjatë martesës tonë ligjore vetëm 3-vjeçare (qershor 2015 – maj 2018, faktikisht e ndarë që në muajin korrik 2017) nuk ka krijuar asnjë pasuri, përkundrazi ka humbur një pjesë të pasurisë që kishte fituar nga puna e prindërve dhe aktualisht pasuria e vetme në emër të tij është me barrë hipotekore për shkak të detyrimeve dhe, për më tepër, ka një vlerë të konsiderueshme detyrimesh vetjake për shkak të mosmenaxhimit të duhur të aktivitetit të tij tregtar dhe pamundësisë së pagimit të*

<sup>59</sup> Shihni tabelën e analizës financiare.

<sup>60</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

*detyrimeve... Pavarësisht sa më sipër, edhe sikur Komisioni ta kryejë analizën financiare në vitet 2011 – 2016 të përbashkët (pavarësisht se unë nuk kam kontribuar në shpenzimet e tij të udhëtimeve apo pagimi i kredive të tij personale), diferenca në analizën financiare është në shumën -926,521.77 lekë, diferencë e cila shkaktohet kryesisht për shkak të shpenzimeve të udhëtimit pa mua të z. L.Gj. Kjo diferencë do të jetë akoma edhe më e vogël nëse në analizën financiare do të përfshihen edhe të ardhurat nga paga në shoqërinë “G.C” sh.p.k., sipas vërtetimit të të ardhurave nga paga për periudhën 1.8.2014 – 31.12.2016 nga shoqëria “G. C”, bashkëlidhur deklaratës Vetting”.*

**113.** Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në tërësi dhe provat e paraqitura prej saj, Komisioni ka kryer edhe një herë analizën financiare, duke mos përfshirë pagesën e tokës bujqësore, pasi subjekti arriti të provoi që ajo është blerë gjatë vitit 1996, kohë në të cilin subjekti nuk njihej me ish-bashkëshortin e saj, si dhe shumën 50,000 euro, pasi u provua që nuk është paguar si kapital nga ana e ish-bashkëshortit. Në përfundim të analizës financiare prej fillimit të detyrës deri në deklaratën Vetting, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë një pamundësi financiare në vlerën -1,206,941.77 lekë. Kjo pamundësi vjen si pasojë e shpenzimeve të kryera nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në lidhje me udhëtimet e tij jashtë shtetit. Konkretisht, shpenzimet TIMS në vitin 2013 janë në shumën 819,358.36 lekë dhe në vitin 2014 në shumën 596,154.10 lekë.

#### **Konkluzion për vlerësimin e pasurisë**

**114.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën Vetting pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**115.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ajo ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**116.** Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjyqësor çmon se pasaktësitë në deklaratim dhe balanca negative e fondeve në vlerën -1,206,941.77 lekë, e cila ka ardhur si pasojë e udhëtimeve jashtë shtetit të ish-bashkëshortit të subjektit në një kohë që ata nuk ishin ende të martuar, si dhe ka si burim të ardhurave të shoqërive tregtare në pronësi të tij, nuk është e mjaftueshme që të pasjellë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

**117.** Komisioni vlerëson të ndalet edhe në disa fakte të cilat lidhen me pasuritë e ish-bashkëshortit të subjektit dhe për të cilat subjekti i ka kaluar barra e provës ose i janë kërkuar shpjegime. Subjekti pas kalimit të barrës së provës arriti të provojë që këto pasuri nuk janë pjesë e bashkësisë ligjore sipas parashikimeve të nenit 73 të Kodit të Familjes. Këto pasuri janë krijuar gjatë kohës që subjekti nuk ishte e martuar me shtetasin L.Gj, si dhe një pjesë e tyre janë krijuar në një kohë shumë të largët nga prindërit e ish-bashkëshortit të saj. E vetmja pasuri

që është krijuar gjatë kohës së bashkëjetesës faktike është pjesëmarrja si ortak në shoqërinë “G.G” sh.p.k., me një vlerë prej 50,000 euro.

**118.** Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj nuk e kanë rregulluar bashkëjetesën e tyre sipas parashikimeve të nenit 164 të Kodit të Familjes. Gjithashtu konstatohet se pasuritë e ish-bashkëshortit, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tij në shoqërinë “G. G” sh.p.k, janë krijuar para lidhjes së martesës, për rrjedhojë këto pasuri bazuar në nenin 77 të Kodit të Familjes janë pasuri vetjake të ish-bashkëshortit të subjektit. Ky konkluzion i Komisionit bazohet edhe në veprimet që kanë ndodhur pas deklaratës *Vetting*, ku disa prej këtyre pasurive janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve të shtetasit L.Gj, por edhe të shoqërive të tij, ndërkohë që subjekti nuk ka përfutur asnjë të ardhur, por edhe nuk është kërkuar miratimi i saj për tjetërsimin e tyre.

**119.** Në lidhje me burimin e këtyre pasurive, nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se ish-bashkëshorti i subjektit dhe babai i tij kanë kryer aktivitet tregtar me xhiro dhe fitim të konsiderueshëm, fakt i cili provohet edhe nga nxjerrjet e llogarive bankare. Këto të ardhura, pavarësisht se nuk kënaqin përcaktimin e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës, duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, pasi provohet që ish-bashkëshorti i saj dhe prindërit e tij kanë pasur të ardhura për të krijuar këto pasuri. Komisioni çmon se periudha në të cilën ish-bashkëshorti i subjektit dhe prindërit e tij kanë investuar për krijimin e këtyre pasurive ka qenë përtej kohës kur personi i lidhur dhe subjekti ishin në kushtet e bashkësisë ligjore. Trupi gjykues konstaton se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave, që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive, nga hetimi administrativ i Komisionit nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të personit të lidhur. Gjithashtu rezultoi e provuar që këto pasuri janë pasuri vetjake të ish-bashkëshortit të saj, të cilat rezultojnë të regjistruara vetëm në emër të tij dhe një pjesë e tyre është tjetërsuar për të shlyer detyrimet që ai ka pasur ndaj palëve të treta.

**120.** Si rrjedhojë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e dijenisë dhe të pranimit të faktit që ka pranuar të përdorë të ardhura për të cilat ka ditur se është krijuar nga të ardhura me burime të kundërligjshme, situatë kjo që do ta bënte të cenueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike, si dhe në përputhje edhe me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>61</sup>, çmon se problematikave të konstatuara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

**121.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

<sup>61</sup> Shihni vendimet nr. 19/2022 dhe nr. 15/2021.

**122.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

**123.** Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin<sup>62</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**124.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**125.** Në deklaratën e kontrollit të figurës, subjekti ka deklaruar se në vitin 2015 nuk i është dhënë vizë nga Ambasada Amerikane për një udhëtim pune të organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme. Nga komunikimi telefonik me punonjësin e ambasadës iu komunikua se arsyeja është gjendja e saj shëndetësore (shtatzënë).

**126.** Në lidhje me këtë deklaramit të subjektit, AKSIK-ja deklaron se ky fakt duhet të merret në kompleksitet të vlerësimit të figurës, duke konsideruar se marrja e vizës së SHBA-së konsiderohet si standard për pastërtinë e figurës, ku aplikanti i nënshtrohet një procedure të imtësishme dhe të besueshme *Vetting*-u. Ndërkohë që refuzimi/revokimi mund të bëhet për disa arsye. AKSIK-ja sjell në vëmendje deklaratën e Ambasadës së SHBA-së në datën 26.1.2017, ku ka deklaruar se do të përdorë të gjitha mjetet ligjore për revokimin/refuzimin e vizave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar. Refuzimi i vizës, deklaroi AKSIK-ja, përkon me periudhën e deklaratës së SHBA-së, duke rekomanduar vlerësimin e këtyre rrethanave në dritën e informacioneve të tjera.

**127.** Nga hetimi i Komisionit në lidhje me këtë gjetje të AKSIK-së, për refuzimin e vizës nga ana e SHBA-së, rezultoi se ka ndodhur në vitin 2015, kur procesi i *Vetting*-ut nuk ekzistonte, ndërkohë deklarata e SHBA-së është në vitin 2017, kur ligji nr. 84/2016 sapo kishte hyrë në fuqi, ndërkohë që provohet qartësisht pretendimi i subjektit se ka qenë shtatzënë me djalin e saj, i cili ka lindur në datën 22.6.2015.

**128.** Komisioni kreu një hetim<sup>63</sup> të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku. Nga hetimi ka rezultuar se në datën 22.5.2019<sup>64</sup> është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* në ngarkim të ish-bashkëshortit të subjektit për veprat penale “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 dhe “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal. Ky procedim është pushuar në datën 13.7.2021.

<sup>62</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 14.10.2022.

<sup>63</sup> Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

<sup>64</sup> Emri i ish-bashkëshortit të subjektit si person që i atribuohet vepra penale është regjistruar në datën 8.4.2021.

**128.1** Në lidhje me këtë procedim, duke marrë në konsideratë: (i) se ai është regjistruar pas plotësimit të deklaratës *Vetting*; (ii) kohën kur subjekti ka qenë e divorcuar; (iii) vepra penale që nuk përfshihen në krimin e organizuar – ai nuk mund të merret në konsideratë në vlerësimin e kriterit të figurës për subjektin e rivlerësimit.

**129.** Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**130.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**131.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë**

**131.1** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**131.2** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

**131.3** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësia personale dhe angazhimi profesional.

**131.4** Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe nga analizimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short, nuk u konstatuan problematika.

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së**

**132.** Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit Oltiana Çifliku rezultojnë se:

- a. Nga të dhënat që ndodhen në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk rezultojnë të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Oltiana Çifliku.
- b. Ndaj subjektit të rivlerësimit Oltiana Çifliku ka materiale hetimore.
  - Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2020, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar ka konfirmuar se nuk ishte regjistruar procedim penal në emër të shtetas Oltiana Çifliku (Gj). Gjithashtu, informon se me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020, është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë kallëzimi penal për znj. Oltiana Çifliku, për nenin 248 të Kodit Penal. Rezultojnë të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2016, për të cilin, pas verifikimeve të kryera, ishte vendosur mosfillimi i procedimit penal (bashkëlidhur CD-ja me vendimet).
  - Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka konfirmuar se:
    - është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 27.3.2018;
    - është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 1.4.2020.

**133.** Drejtorja e Koordinimit Institucional, si dhe sektori i protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2021, bëjnë me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezultojnë se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit Oltiana Çifliku. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2020 rezultojnë se nuk ka asnjë ankesë të regjistruar ndaj prokurores Oltiana Çifliku. Gjithashtu, rezultojnë që nuk ka masa disiplinore në karrierën e saj.

## **DENONCIME**

**134.** Për subjektin e rivlerësimit janë administruar dy denoncime të paraqitura pranë Komisionit, si vijon:

### **Denoncim i shtetasit P.K<sup>65</sup>**

Denoncuesi pretendon se subjekti nuk ka mbajtur qëndrim të drejtë me të, pasi nuk ka pranuar kërkesat e tij me shkrim, nuk i ka dhënë informacion për hetimin, si dhe ka dashur të zvarrisë hetimin. Ai pretendon se kur ka vendosur moskompetencën tokësore, nuk i ka njoftuar vendimin, si dhe nuk ka konsideruar si persona që kanë kryer veprë penale mjeken dhe infermieren që kanë lëshuar raportet mjekësore. Denoncuesi gjithashtu deklaron se subjekti duhet të kishte pyetur të kallëzuarën, shtetasen A.Xh.

Nga aktet e depozituara prej denoncuesit rezultojnë se:

---

<sup>65</sup> Nr. \*\*\*, datë 28.5.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 6.3.2020.

- Subjekti në datën 21.3.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të kallëzimit nr. \*\*\*, duke argumentuar se vepra penale është parashkruar, pasi kanë kaluar 5 vjet.

Ky vendim i saj është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2018. Në këtë vendim është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal dhe kryerja e veprimeve të nevojshme hetimore.

Në lidhje me vendimin e mosfillimit të subjektit të rivlerësimit, rezulton se ajo nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi nuk është verifikuar se cili ka qenë momenti kur u përdor dokumenti i pretenduar i falsifikuar, në mënyrë të tillë që të vendosej nëse jemi para parashkrimit të veprës penale. Gjithashtu, subjekti në vendim nuk është shprehur në lidhje me veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” si administratore të shtetas A.Xh.

Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore, si dhe nuk është argumentuar vendimi i mosfillimit i datës 21.3.2018.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>66</sup> se: *“Kallëzimi penal lidhet me faktin e pretenduar nga kallëzuesi shtetasi P.K se shtetasja A.Xh ka paraqitur dokumente shëndetësore të falsifikuara të lëshuara në datat 8 shkurt – 28 shkurt 2013, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë procesit gjyqësor të shqyrtimit të çështjes civile me nr. \*\*\* akti, datë 1.3.2013, me objekt rivendosje në afat për paraqitjen e ankimit kundër vendimit nr. \*\*, datë 4.1.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë... Kallëzuesi pretendon se shtetasja A. Xh ka konsumuar elemente të veprës penale “Dëshmia e rreme”, parashikuar nga neni 306, pikat 1, 2 të Kodit Penal; “Falsifikim i dokumenteve shëndetësore”, parashikuar nga neni 188/1 i Kodit Penal; “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal; “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal... Në përfundim të verifikimit të materialit kallëzues, është vendosur mosfillimi i procedimit penal për këtë material kallëzues. Ky vendim bazohet në nenet 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale. Arsyetimi i vendimit të mësipërm bazohet në nenin 66 të Kodit Penal... Parashkrimi i ndjekjes penale do të thotë shuarje e saj, për shkak se nga çasti i kryerjes së veprës penale deri në çastin e marrjes si të pandehur të shtetasit kanë kaluar afatet e caktuara në ligj, sipas masës së dënimit të parashikuar nga dispozita përkatëse e Kodit Penal... Sa i përket pretendimit për mungesën e veprimeve hetimore, referuar praktikës dhe doktrinës juridike, gjatë fazës së kallëzimit penal mund të kryhen vetëm veprime verifikuese në lidhje me materialin e paraqitur. Për t’u kryer veprime hetimore është e domosdoshme që të jetë regjistruar procedimi penal, pasi ka dyshim të arsyeshëm për kryerjen e një vepre penale. Në rastin konkret, për shkak të parashkrimit të veprave penale dhe ndalimit ligjor për ushtrimin e ndjekjes penale, është vendosur mosfillimi... Ky qëndrim në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale rezulton se është edhe qëndrimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila në përfundim të hetimeve ka paraqitur kërkesën për pushim, ndër të tjera dhe për këtë fakt penal, pikërisht për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përfundimisht me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 10.11.2020, ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka vendosur pushimin e çështjes penale me nr. \*\*\*, viti 2018. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 25.11.2020, pasi nuk është ankimuar nga palët”.*

---

<sup>66</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti duhej të kishte treguar kujdesin e duhur dhe të bëheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, pavarësisht faktit se në dukje mund të ishim përpara parashkrimit të veprës penale. Në lidhje me moskryerjen e këtyre veprimeve, çmohet se ato nuk mund të konsiderohen si mangësi profesionale, pasi, sikundër ka rezultuar, për këtë çështje gjyqësore është vendosur përfundimisht pushimi i saj nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në datën 19.11.2018, denoncuesi me shkresë zyrtare i ka kërkuar informacion subjektit në lidhje me ecurinë e hetimeve, pasi kishin kaluar 5 muaj nga vendimi i gjykatës, duke kaluar edhe afati tremujor i hetimit të çështjes penale. Në lidhje me këtë kërkesë rezulton se nuk ka përgjigje nga ana e subjektit të rivlerësimit, veprim i cili nuk përputhet me parashikimet e neneve 279/a dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>67</sup> se: *“Sa i përket pretendimit të kallëzuesit për faktin se nuk i është kthyer përgjigje rreth kërkesës së tij për informacion në lidhje me ecurinë e hetimeve, sqaroj se në përputhje me kërkesat e nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, në përfundim të hetimeve prokurori njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurin, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit. Detyra kryesore funksionale e prokurorit është të kryejë hetime për të provuar akuzën në favor të shtetit dhe në përfundim të hetimeve njofton palët për rezultatet e tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural penal”.*

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti duhej t'i kishte kthyer përgjigje kërkesës së denoncuesit si detyrim ligjor i parashikuar nga neni 279/a dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave viktimja ka të drejtë të kërkojë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet e të marrë kopje të akteve dhe provave që ndodhen në fashikullin e prokurorit.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, parashikuar nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Subjekti me vendimin datë 24.10.2019 ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore dhe kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Tiranë. Vendimi i moskompetencës nuk rezulton t'i jetë njoftuar shtetasit P.K, fakt i cili provohet edhe me procesverbalin e dorëzimit të kopjes së akteve të hetimeve paraprake të datës 12.2.2020, sipas të cilit aktet i dorëzohen avokates së Z. K sipas kërkesës së këtij të fundit të datës 14.1.2020.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>68</sup> se: *“Lidhur me faktin që vendimi i moskompetencës nuk i është njoftuar shtetasit P.K, vendimi i moskompetencës është një vendim i ndërmjetëm dhe jopërfundimtar. Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon detyrimin për njoftimin e këtij vendimi subjekteve procedurale. Referuar nenit 84 të Kodit të Procedurës Penale “Moskompetenca e shpallur gjatë hetimeve paraprake”, i cili parashikon: 1. Kur gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre prokurori konstaton moskompetencën e vet, për*

---

<sup>67</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

<sup>68</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.



*çdo lloj shkaku vendos dërgimin e akteve prokurorit pranë gjykatës kompetente. 2. Kur prokurori shpall moskompetencën, ai njofton menjëherë të dyja gjykatat. Gjykata, brenda tri ditësh nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate”.*

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse.

Nga aktet e vëna në dispozicion nga denoncuesi, të cilat duket se janë fashikulli i plotë i hetimeve të kryera nga subjekti, pasi janë administruar me procesverbal për dorëzimin e akteve të hetimeve paraprake, rezultojnë këto veprime hetimore:

- a. Në datën 13.7.2018 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*.
- b. Pas gati 9 muajsh pa kryer veprime, subjekti në datën 1.4.2019 ka marrë vendimin për kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik.
- c. Në datën 21.5.2019, Instituti i Policisë Shkencore ka vënë në dispozicion aktin e ekspertimit.
- d. Pas gati 4 muajsh nga depozitimi i aktit të ekspertimit, në datën 6.9.2019 është marrë në pyetje shtetasja G.Sh, e cila është mjekja që ka lëshuar raportet mjekësore.
- e. Pas gati 5 muajsh nga depozitimi i aktit të ekspertimit, në datën 4.10.2019 është marrë në pyetje shtetasja F.P, e cila është infermiere që ka mbajtur regjistrin e raporteve të mjekes G.Sh.
- f. Pas gati 1 viti e 5 muajsh, në datën 24.10.2019 subjekti ka marrë vendimin, duke deklaruar moskompetencën në lidhje me këtë procedim penal.

Për sa më sipër, duket se subjekti ka zvarritur pa arsye hetimet e këtij procedimi penal, si dhe nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për një periudhë prej 9 muajsh.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>69</sup> se: *“Në vijim janë kryer veprimet hetimore të mëposhtme, duke mbajtur në konsideratë se muaji gusht sipas parashikimeve ligjore të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është periudha e lejes vjetore së detyrueshme të organeve të drejtësisë<sup>70</sup>:*

- Në datën 11.9.2018 është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethana të hetimit kallëzuesi P.K, i cili është ripyetur edhe në datën 20.9.2018.
- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2018, i është kërkuar dokumentacion Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2018, ka kthyer përgjigje, administruar në datën 4.10.2018.
- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2018, i është kërkuar dokumentacion Gjykatës së Lartë, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2018, ka kthyer përgjigje, administruar në datën 7.11.2018.

<sup>69</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

<sup>70</sup> Neni 23 “Pushimet vjetore”: “...5. Pushimet vjetore mund të merren njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së magjistratit dhe në përputhje me kërkesat e funksionit. Në çdo rast, pushimet duhet të përfshijnë një periudhë trijavore pa ndërprerje, gjatë muajit gusht, përveç kur kërkesat e ushtrimit të funksionit kërkojnë vazhdimin e aktiviteteve të gjykatës ose prokurorisë”.

- Në datën 31.10.2018, prokurori ka marrë vendim për këqyrje dokumentacioni, përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2018, drejtuar Qendrës Shëndetësore Durrës.
- Në datën 8.11.2018 është mbajtur procesverbali për këqyrjen në zbatim të vendimit të mësipërm.
- Në datën 25.1.2019, prokurori ka marrë vendim për sekuestrim dokumentacioni (kartela), drejtuar Qendrës Shëndetësore Durrës.
- Në datën 25.1.2019, prokurori ka marrë vendim për sekuestrim dokumentacioni (regjistri), drejtuar Qendrës Shëndetësore Durrës.
- Në datën 20.2.2019 është mbajtur procesverbali për sekuestrimin në zbatim të vendimit të mësipërm (kartela).
- Në datën 20.2.2019 është mbajtur procesverbali për sekuestrimin në zbatim të vendimit të mësipërm (regjistri).
- Në datën 1.4.2019, prokurori ka marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik grafik, përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2014.

Sa më sipër, gjatë kësaj periudhe 9-mujore nga data e regjistrimit 13.7.2018 deri në datën e hartimit të vendimit të ekspertimit, 1.4.2019, rezulton se janë urdhëruar dhe janë kryer veprime hetimore, si: pyetje personash, këqyrje, sekuestrim, kërkesa për informacion dhe administrim dokumentacioni. Pra, rezulton se gjatë kësaj periudhe është kryer hetim dinamik, i plotë dhe i gjithanshëm.

Pas administrimit të aktit të ekspertimit grafik në datën 28.5.2019, është vijuar sërish me veprime hetimore...

Pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse. Nga provat e depozituara prej subjektit rezulton se ajo ka kryer të gjitha veprimet hetimore, por ndërkohë duhej të tregonte kujdesin e duhur në lidhje me kryerjen e disa veprimeve hetimore në një kohë më të shkurtër.

### **Denoncim i shtetasit T.N<sup>71</sup>**

Denoncuesi<sup>72</sup> pretendon se subjekti nuk e ka njoftuar në lidhje me kallëzimin penal të kryer nga shtetasi E.M. Sipas denoncuesit, procedimi ka nisur në vitin 2016 dhe subjekti e ka kaluar çështjen për gjykim në vitin 2019, duke mos e marrë asnjëherë në pyetje as denoncuesin, por as shtetasin tjetër, E.G. Denoncuesi deklaron se policët e patrullimit, kur janë thirrur në gjykatë, kanë deklaruar se shtetasi E.M ka mashtruar. Ai vijon të deklarojë se nuk janë kryer veprime hetimore, si dhe nuk ka asnjë provë për të provuar se ato kanë kanosur shtetasin E.M, i cili për më tepër ka ndërruar jetë.

Komisioni ka analizuar edhe deklaratimet e OPGJ-së D.H në kamerë, realizuar nga emisioni investigativ “S”, ku ai deklaron: “OPGJ, D.H: Mos u kap me asnjë oficer. Unë jam oficer, siç janë dhe 200 të tjerë. Nuk jam unë, mund të jetë dikush tjetër në këtë çështje, por realisht është kjo. Kallëzimin e ka marrë oficer tjetër. Ma ka deleguar prokurori. Dosja më është deleguar mua, merr dosjen, zgjidhe, vazhdo! Unë kam bërë ca veprime fillimisht atë kohë dhe s’jam

<sup>71</sup> Nr. \*\*\* , datë 31.5.2023.

<sup>72</sup> Denoncimi është bërë edhe në emisionin “S”.

[https://\\*\\*\\*.al/2019/10/22/\\*\\*\\*-arroganca-e-prokurores-oltiana-cifliku-ndaj-\\*\\*\\*-e-more-daten-e-gjykimit/](https://***.al/2019/10/22/***-arroganca-e-prokurores-oltiana-cifliku-ndaj-***-e-more-daten-e-gjykimit/)

*marrë fare dy vjet. Meqenëse pyete, po të them. Unë s'kam pse rrej, sepse çfarë kuptimi ka kjo? Shiko si funksionon! Prokurori na jep detyra neve, përderisa mua s'më ka dhënë detyra gjithë këto vite...! Po që është dy vjet kohë, domethënë që unë, as unë, asnjë oficer tjetër, nuk ka bërë asnjë lloj detyre, asnjë veprim”.*

Bazuar në deklaratimet e OPGJ-së rezultojnë se nga ana e subjektit nuk janë kryer veprime hetimore për një periudhë 2-vjeçare, duke u zvarritur procedimi pa arsye.

Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore: (i) duke mos i thirrur për t'u pyetur dy të pandehurit; (ii) duke mos administruar kamerat e sigurisë; (iii) duke mos u kryer ballafaqimi midis personave në hetim dhe të kallëzuarit; (iv) duke mos i njoftuar në lidhje me procedimin penal personat nën hetim; (v) duke mos i marrë në konsideratë deklaratimet e punonjësve të policisë, si dhe janë zvarritur hetimet për një periudhë trevjeçare.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi<sup>73</sup> se: “Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 4.11.2016, mbi bazën e kallëzimit të shtetas A.S për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal ndaj shtetasit B.I. Pavarësisht se ky procedim është iniciuar mbi bazën e një kallëzimi të një shtetasi në bazë të 283 të Kodit të Procedurës Penale, gjatë hetimit, për shkak të subjekteve të përfshira dhe fakteve penale të ndërlidhura, është bashkuar me dy procedime të tjera të regjistruara po pranë kësaj prokurorie. Për shkak të kompleksitetit të kësaj çështjeje, fakteve të tjera të shtuara, rritjen e numrit të veprimeve hetimore dhe kohën e nevojshme për të kryer analizën faktike dhe ligjore, për konkludimin në përgjegjësinë penale konkrete, është vendosur zgjatja e afateve, vendimmarrje e njohur nga palët, e mbështetur nga Prokurori i Përgjithshëm dhe vlerësuar si e drejtë nga Gjykata.

Rrethanat e faktit të procedimit penal nr. \*\*\* lidhen me pretendimin e kallëzueses – shtetas A.S, se i kallëzuarit, shtetasi B.I, ka kryer veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, pasi nga muaji korrik i vitit 2015 e deri në datën e paraqitjes së kallëzimit penal, 2.11.2016, ky shtetas i kishte marrë kallëzueses shuma të ndryshme parash, me qëllim që ta ndihmonte atë për probleme të ndryshme personale dhe ligjore. Ky shtetas jo vetëm është prezantuar në pozicione pune të rëndësishme – Sekretar i Parë i Interpolit – por e ka gënjyer dhe kërcënuar atë. Gjatë kësaj kohe, vlera e marrë nëpërmjet mashtimit ka qenë e konsiderueshme, përfshirë para cash dhe automjet.

Në datën 4.11.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit E.M paraqitur një ditë më pas, në datën 3.11.2016, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2016 për veprën penale “Kanosja”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 84 dhe 25 të Kodit Penal ndaj shtetasve T.N dhe E.G.

Rrethanat e faktit të procedimit penal nr. \*\*\* lidhen me pretendimin e kallëzuesit E.M se një ditë më herët ishte ndjekur nga katër persona të panjohur, të cilët në datën 3.11.2016 kanë tentuar ta merrnin në automjetet nëpërmjet ushtrimit të forcës. Ky shtetas gjatë kallëzimit të tij ka treguar lidhjen e mundshme të kësaj ngjarjeje me kallëzimin e paraqitur nga shtetasja A.S për shkak të përfshirjes së babait të tij, shtetasit B.M, në kallëzimin e paraqitur nga A.S. Gjatë hetimeve të këtij procedimi nr. \*\*\*, viti 2016, ka rezultuar se shtetasi B.I kishte kërcënuar

---

<sup>73</sup> Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

shtetasin B.M dhe janë identifikuar autorët e kanosjes së shtetasit E.M, si T.N dhe E.G. Këta shtetas kanë lidhje shoqërore me shtetasin B.I.

Sa më sipër, në kushtet kur rrethanat objekt hetimi të dy çështjeve dhe subjektet procedurale kanë lidhje dhe ndikojnë te njëra-tjera, në bazë të nenit 79 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon kriteret për bashkimin e procedimeve gjatë hetimit, është vendosur bashkimi i këtyre dy procedimeve në një procedim të vetëm, të numërtuar si procedimi nr. \*\*\* i vitit 2016. Në kushtet kur u zgjerua fusha e hetimit, me një tjetër vepër penale të mundshme, lindi nevoja për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore edhe në lidhje me këtë vepër penale të re.

Në datën 18.2.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës mbi bazën e kallëzimit të shtetasit E.M ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2018, për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, nga persona të paidentifikuar. Ky procedim është regjistruar nga një tjetër prokuror pranë kësaj prokurorie, i cili ka kryer dhe veprimet e para hetimore dhe nga hetimi ka rezultuar se ky procedim mund të kishte lidhje me kallëzimin e paraqitur nga po i njëjti shtetas në vitin 2016.

Nga drejtuesi i prokurorisë me vendimin e datës 19.2.2018 është bashkuar procedimi nr. \*\*\* i vitit 2018 me procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2016. Në kushtet e paraqitjes së këtij procedimi të ri, për të cilin kishte nevojë dhe për identifikimin e autorëve të mundshëm, sërish u rrit kompleksiteti i çështjes dhe nevoja për të vijuar me veprime hetimore shtesë.

Në përfundim të hetimeve të procedimit penal nr. \*\*/2016, me të cilin janë bashkuar edhe dy procedimet e tjera, në bazë të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale shtetasit janë njohur me aktet respektive të njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur...

Të pandehurve të mësipërm u janë njohur të gjitha të drejtat procedurale të parashikuara nga neni 34/a i Kodit të Procedurës Penale “Të drejtat e të pandehurit”, duke i njoftuar secilit letrën e të drejtave të të pandehurit dhe janë pyetur në cilësinë e subjekteve procedurale të pandehur, sikurse provohet në procesverbalet e datave 30.1.2019 dhe 1.2.2019, në prezence të mbrojtësve të tyre... Sa i përket pretendimeve të të pandehurve se nuk janë kryer veprimet hetimore të pretenduara prej tyre, për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë... Në bazë të nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale “Funksionet e prokurorit” parashikohet se: “Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm”,... është tërësisht kompetencë ligjore e prokurorit të ushtrojë ndjekjen penale dhe të drejtojë dhe kontrollojë hetimet që çmon të domosdoshme në funksionin të të provuarit të akuzës në gjykim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.9.2019, gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur dërgimin në gjykim të çështjes penale, duke theksuar se: “...Lidhur me pretendimet e bëra nga avokatët mbrojtës të të pandehurve për parregullsi në fazën e hetimeve paraprake, si dhe kalimi i afateve të hetimit, gjykata vlerëson se ato nuk gjejnë mbështetje nga analiza e provave të paraqitura prej organit të prokurorisë”.

Në shqyrtimin në themel të çështjes, zhvilluar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, janë marrë në shqyrtim të gjitha provat e kërkuara nga prokurori dhe ato që kërkojnë nga të pandehurit.

*Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.7.2024, ka vendosur:*

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit B.I për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal. Dënimin e tij në bazë të nenit 143/2 të Kodit Penal me 3 (tri) vite burgim.*
- *Deklarimin fajtor të të pandehurit T.N për kryerjen e veprës penale “Heqja e paligjshme e lirisë”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 110/2 dhe 22 të Kodit Penal. Dënimin e tij në bazë të neneve 110/2 dhe 22 të Kodit Penal me 3 (tri) vite burgim.*
- *Deklarimin fajtor të të pandehurit E.G për kryerjen e veprës penale “Heqja e paligjshme e lirisë”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 110/2 dhe 22 të Kodit Penal. Dënimin e tij në bazë të neneve 110/2 dhe 22 të Kodit Penal me 3 (tri) vite burgim”.*

Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se nuk mund të vijojë më tej me vlerësimin e kësaj çështjeje, për sa kohë ka një vendim gjykate, e cila i ka dhënë të drejtë subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se: *“Lidhur me pretendimet e bëra nga avokatët mbrojtës të të pandehurve për parregullsi në fazën e hetimeve paraprake, si dhe kalimin e afateve të hetimit, gjykata vlerëson se ato nuk gjejnë mbështetje nga analiza e provave të paraqitura prej organit të prokurorisë”.*

Në lidhje me zgjatjen e hetimeve nga ana e subjektit, është provuar se ato janë zgjatur për shkak të kompleksitetit të çështjes, nga ku rezulton se janë bashkuar tri procedime penale.

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

**135.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

**136.** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Pavarësisht nga ky konstatim, si dhe nga sa u përshkrua më sipër, rezultoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit në një rast nuk ka qenë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me aftësinë profesionale të një prokurori. Si rrjedhojë e sa më sipër, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara nuk ngrihen në nivelin e shkakut, që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e këtij ligji.

**137.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Oltiana Çifliku, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 4.9.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
**Kryesues**

**Genta Tafa (BUNGO)**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*